



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 33/2021 (JR)  
Datë 17.06.2021

Nr. 59 i vendimit  
Datë 19.11.2024

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 19.11.2024, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 33/2021 (JR), datë 17.06.2021, që i përket:

**ANKUES** Subjekti i rivlerësimit Artan Hazbi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 375, datë 26.04.2021.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të ngritura në ankim dhe në parashtrimet me shkrim të depozituara para seancës gjyqësore, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 375, datë 26.04.2021, të Komisionit të

Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Artan Hazbi (në vijim “subjekti i rivlerësimit/ankuesi”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e nr. ligjit 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar të kontrollit të plotë të pasurisë, duke konstatuar se:
  - a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
  - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - c) ka mosdeklarim pasurie ndër vite;
  - d) ka kryer deklarim të rremë;
  - e) bashkëjetuesja e subjektit ka qenë në situatën e konfliktit të interesave.
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportin e vlerësimit të hartuar për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Artan Hazbi, duke u bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 375, datë 26.04.2021, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.
  - Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruar, pasi ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
  - Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
7. Këto konkluzione të Komisionit janë bazuar në përfundimet se:

7.1 Lidhur me pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, dhe banesë/ndërtesë 57,3 m<sup>2</sup>, me adresë Konispol, Sarandë, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri.

7.2 Lidhur me pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup> për ndërtim banese, në rrugën “{\*\*\*}”, Sarandë, përfituar nga subjekti i rivlerësimit në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 15.3.1996, të Këshillit Bashkiak të Sarandës, Komisioni vlerësoi se këto veprime bien ndesh me etikën dhe detyrën e subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi dhe se cenojnë figurën e prokurorit. Ai nuk ka deklaruar vlerën reale të kësaj pasurie (të rivlerësuar) në deklaratën “vetting”, duke e fshehur atë.

7.3 Lidhur me pasurinë e llojit “truall” për ndërtim me sipërfaqe 608 m<sup>2</sup>, rruga “{\*\*\*}”, Sarandë, përfituar nga subjekti i rivlerësimit në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.08.1999, të Këshillit Bashkiak të Sarandës, Komisioni vlerësoi se subjekti e ka përfituar këtë pasuri në mënyrë të padrejtë, pasi kishte përfituar edhe më herët pasuri të tjera publike si banor i Sarandës, si dhe ka fshehur vlerën reale të kësaj pasurie në deklaratën “vetting”, duke deklaruar atë të përfitimit të saj në vitin 2002. Subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit, pasi ndërkohë që ushtronte funksionin si oficer i policisë gjyqësore dhe, më pas, si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Sarandë, ka përfituar si investitor një pasuri publike dhënë me qëllim zhvillimin e qytetit dhe nuk ka kryer në vijimësi, në një hark kohor shumë të gjatë, asnjë investim në këtë pasuri duke e trajtuar si pasuri private dhe krejtësisht për qëllime personale, e cila, pas rivlerësimit, ka shtuar disa herë vlerën e pasurive të subjektit të rivlerësimit. Komisioni i konsideron këto veprime të tilla që cenojnë figurën e tij si prokuror.

7.4 Lidhur me pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe ndërtimi 77 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Sarandë, blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë. Transaksionet e kryera me këtë pasuri ishin të dyshimta (blerë në vitin 2007 për vlerën 1.800.000 lekë, rivlerësuar në vitin 2017, në vlerën 65.065 euro dhe këmbyer me një pasuri truall + hotel në Ksamil), duke krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë ndër vite, duke fshehur vlerën reale të investimit për këtë pasuri, si dhe ndodhet në mungesë të burimeve financiare të ligjshme.

7.5 Lidhur me pasurinë “apartament” 1+1, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup> + sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*} Sarandë, përfituar nga privatizimi me EKB-në, Komisioni vlerësoi se: subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë fitimin e pronësisë mbi truallin me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> dhe nuk ka provuar pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në vitin 1998. Veprimet e kryera prej tij, duke e shitur këtë pasuri të përfituar për qëllim banimi dhe përfitimi më pas edhe të pasurive të tjera me statusin si i pastrehë, janë veprime që cenojnë etikën dhe figurën e prokurorit.

7.6 Lidhur me pasurinë gjendje cash në shumën 210.000 lekë, jashtë sistemit bankar, të deklaruar në deklaratën “vetting” me burim nga kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes, si dhe nga shitja e ulla për vaj, nga Komisioni është vlerësuar se: nuk janë konsideruar në analizë financiare të ardhurat nga shitja e ulla për vaj sepse nuk kanë dokumentacion ligjor të rregullt. Lidhur me këtë deklarim të subjektit, ai është vlerësuar në kuadër të analizës financiare.

7.7 Lidhur me *aktivitetin e kultivimit të ullinjve*, në kuadër të të cilit subjekti i rivlerësimit ka përfituar në vitin 2011 subvencion shtetëror në shumën 153.000 lekë, Komisioni ka vlerësuar se: *subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë figurën e tij si prokuror.*

7.8 Lidhur me *transfertën bankare të datës 29.12.2006, në shumën 860.000 lekë*, të kryer nga ana e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në llogarinë bankare të subjektit, Komisioni ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaramin periodik vjetor, duke fshehur këtë transfertë dhe qëllimin e kryerjes së saj, nga hetimi dhe kontrolli që kryente ILDKPKI-ja.*

7.9 Për pasurinë “*apartament banimi*” me sipërfaqe 60,47 m<sup>2</sup>, sh. {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, lagjja “{\*\*\*}”, Lushnjë, në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. V. H., Komisioni: (i) *Ka vlerësuar të mos përfshijë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit rezultatin e hetimit lidhur me këtë pasuri, për sa kohë kjo çështje (momenti i pagimit të shumës për blerjen e apartamentit, viti 2007 apo 2013) është duke u trajtuar nga një organ tjetër, duke lënë të pavlerësuar edhe burimin për krijimin e kësaj pasurie, si dhe vlerëson të mos e përfshijë këtë pasuri në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.* (ii) *Nuk ka vlerësuar të nevojshëm pezullimin e procesit të rivlerësimit për subjektin Artan Hazbi, deri në zgjidhjen e kësaj çështjeje nga organi kompetent, apo zgjidhjen lidhur me pretendimet e subjektit, pasi vlerëson se provat e tjera kanë arritur nivelin e provueshmërisë dhe se mospërfshirja e kësaj pasurie në vlerësimin e subjektit nuk ndryshon rezultatin e hetimit administrativ të arritur nga Komisioni, në mënyrë të tillë që të ndikojë në vendimmarrjen përfundimtare.*

7.10 Lidhur me *aktivitetin e mbarështimit të lopëve të kryer nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit*, znj. V. H., Komisioni ka vlerësuar se *personi i lidhur ka vepruar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi dhe se nuk justifikohet krijimi i kësaj pasurie me burime të ligjshme.*

7.11 Lidhur me *gjendjen cash jashtë sistemit bankar, të deklaruar nga bashkëjetuesja në deklaratën “vetting”, në vlerën 1.200.000 lekë*, Komisioni ka vlerësuar se *trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi, nuk mundi të krijojë ndonjë lidhje dhe, për pasojë, bindjen se shumt cash të deklaruar nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit janë me burim nga dëmshpërblimi i prindërve përfituar në vitet 2010, 2011 dhe 2013 dhe, për pasojë, vlerëson se ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes cash të deklaruar në deklaratën “vetting”.*

7.12 Lidhur me pasurinë *ndërtesë dhe truall në Ksamil (investim në ndërtimin e një hoteli)*, Komisioni ka vlerësuar se *kjo është një pasuri e krijuar pas deklaratës “vetting” dhe, si e tillë, duhet të kontrollohet dhe të verifikohet lidhur me ligjshmërinë e saj nga organet kompetente, pa dashur t’i zëvendësojë ato në ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe duke konsideruar gjetjet e tjera të mjaftueshme për marrjen e një vendimi përfundimtar lidhur me rivlerësimin e subjektit Artan Hazbi.*

7.13 Lidhur me pasurinë e llojit “*apartament*” në Tiranë, kompleksi “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, pallatet e {\*\*\*}, Komisioni ka vlerësuar se: *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri. Ai nuk mundi të provojë mundësitë financiare me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues krijoi bindjen se nëpërmjet veprimeve të njëpasnjëshme lidhur me blerjen e kësaj pasurie, ka pasur përpjekje për fshehjen e së vërtetës lidhur me këtë pasuri, duke e konsideruar pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.*

7.14 Lidhur me pasurinë *truall me sip. 277 m<sup>2</sup>, blerë më datë 05.11.2002* shtetasit N. Ç. kundrejt shumës 277.000 lekë, si dhe shitur më datë 08.11.2002 shtetasit M. V., kundrejt shumës 400.000 lekë, Komisioni ka vlerësuar se: *subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk ka paguar detyrimet tatimore për buxhetin e shtetit lidhur me të ardhurat e realizuara nga transaksioni i kryer.*

7.15 Lidhur me *analizën financiare të kryer për periudhën 2003-2016*, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka një rezultat negativ prej (-) 5.547.482 lekësh.

### III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

8. Kundër vendimit nr. 375, datë 26.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 10.06.2021, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Artan Hazbi, mbështetur në nenet 62 e vijues të ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar që *të vlerësohet pozitiv rezultati i hetimit administrativ në lidhje me pasurinë, duke u korrigjuar edhe tabela e analizës financiare, të çelet hetimi për profesionalizmin dhe pastërtinë e figurës dhe, përfundimisht, të rikonfirmohet në detyrë.*
9. Në mbështetje të pretendimeve të ngritura në ankim, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj në datën 14.11.2024, parashtrime me shkrim me aktin e titulluar “Shtesë apelimi”, së bashku me disa akte shkresore për të cilat kërkoi të merren si prova të reja, si vijojnë: (i) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.11.2024, e deklaruesve A., E. dhe Z. H.; (ii) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.11.2024, e subjektit të rivlerësimit; (iii) kërkesë e subjektit, datë 14.10.2024, drejtuar Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë dhe një raport vlerësimi i specialistëve zooteknikë F. G. dhe K. K.; (iv) kërkesë po e datës 14.10.2024, drejtuar së njëjtës agjenci dhe vlerësimi agroekonomik i kryer nga specialistë të këtij institucioni; (v) prokurë e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2024 e të përfaqësuarave A. dhe Z. H., për caktimin e E. H. si përfaqësues të tyre ligjor; (vi) vërtetim i Bashkisë Konispol nr. {\*\*\*} prot., datë 06.11.2024, për punësimin e z. E. H. pranë kësaj bashkie dhe librezë kontributesh për sigurim shoqëror dhe shëndetësor të znj. A. H. (akte në fotokopje, të panjësuar me origjinalin, të nënshkruara në çdo fletë nga vetë subjekti i rivlerësimit).

### IV. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

#### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a. Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit kalimtar, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Artan Hazbi, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*ii. Legjitimimi i ankuesit*

11. Ankuesi, legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se është subjekt rivlerësimi dhe ka depozituar ankimin brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit<sup>1</sup> të vendimit të Komisionit.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.

Në verifikim të këtyre kriterëve, trupi gjykues analizoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja bashkëlidhur parashkrimeve me shkrim të depozituara në Kolegj para seancës gjyqësore. Nga leximi harmonik i parashkrimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012<sup>2</sup> dhe nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” e “d” të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pamundësinë e tij për t’i paraqitur ato gjatë shqyrtimit në Komision. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja.

13. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashkrimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve dhe, për rrjedhojë, vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashkrimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit.

*B. Shkaqet e ankimit dhe vlerësimi i trupit gjykues*

➤ *Shkaqe ankimi me natyrë të përgjithshme*

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasaktësitë në deklaratimet e tij lidhur me pasurinë, kanë ardhur nga pakujdesia dhe jo me qëllim fshehjen apo deklarimin e rremë, pasi ato kanë ndodhur për shkak të:
- moskushtimit të rëndësisë së duhur procesit të plotësimit të deklaratave periodike vjetore, megjithëse asnjëherë me qëllim fshehjeje, mosdeklarimi apo deklarimi të rremë;

<sup>1</sup> Komisioni, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 25.05.2021, i ka njoftuar vendimin e arsyetuar nr. 375, datë 26.04.2021, subjektit të rivlerësimit, i cili ka konfirmuar marrjen dijeni më datë 26.05.2021.

<sup>2</sup> Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon: “[...] Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

- ii. moskushtimit të rëndësisë së duhur plotësimin të deklaratës së pasurisë *vetting*, pas miratimit të ligjit nr. 84/2016, nisur nga parashikimi ligjor se quhej i justifikuar subjekti, pasuria e të cilit nuk e kalon dyfishin e të ardhurave;
  - iii. harresës së rrethanave të ndryshme, por që pavarësisht akteve, rrethanave e provave që nuk i kujtoheshin, çdo përgjigje e ka dhënë me vërtetësi, duke shpjeguar se fakti, rrethana, shuma nuk i kujtohej. Kjo në funksion të të qenit sa më i vërtetë, sa më transparent, për arsye që të mos bënte deklaram të rremë.
15. Duke e analizuar këtë pretendim në raport me kuadrin ligjor të miratuar për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, e konkretisht me parashikimet ligjore në pikën 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 30, 31, 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcën 2 bashkëlidhur ligjit, si dhe me udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, *“Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklaram të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*”, trupi gjykues vëren se këto dispozita përcaktojnë qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi dhe vërtetësi çdo pasuri të paluajtshme e të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, në pronësi, posedim dhe përdorim, likuiditetet, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur të tyre. Këto akte ligjore nuk e përlligjin harresën apo ndonjë formë tjetër pakujdesie, aq më tepër në plotësimin e deklaratës *vetting*, kontrolli i së cilës ka rol thelbësor në vlerësimin e kriterit të pasurisë.
16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në vlerësimin e çështjes së tij, është treguar subjektiv e i njëanshëm dhe ka përdorur një standard tjetër në raport me subjektet e tjera, duke i rënduar pozitën. Subjekti pretendon se në tërësi, në analizën ekonomike të kryer, Komisioni nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në çështjet e tjera të ngjashme, pasi nuk ka njohur si të ardhura të ligjshme, pensionet e prindërve, të ardhurat e krijuara nga bujqësia, blegtoria, pemëtaria, bletaria etj.
17. Trupi gjykues konstaton se ky pretendim ngrihet nga subjekti në mënyrë të përgjithshme, pa specifikuar se cilit vendim konkret të Komisionit i referohet kur pretendon se ai ka vlerësuar ndryshe për subjekte të tjera të rivlerësimit që pretendohet se ndodhen në rrethana identike me subjektin, si dhe pa marrë në konsideratë se çdo çështje paraqitet me faktet dhe rrethanat e veta specifike, të cilat nuk mund të jenë identike me rastin e tij.
18. Trupi gjykues vlerëson se fakti që vlerësimi i provave nga Komisioni ka qenë i ndryshëm nga vlerësimi i subjektit të rivlerësimit nuk nënkupton mungesë të analizimit dhe vlerësimit të provave dhe as subjektivizëm dhe, në këtë kuptim, ky qëndrim ndryshe nuk e bën Komisionin as subjektiv dhe as të njëanshëm.
- *Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit*
19. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e tij, ka ngritur shkaqe ankimi me të cilat kundërshton konkluzionet e Komisionit mbi të cilat është bazuar dhënia e masës disiplinore të shkarkimit

nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi, por njëkohësisht ka kundërshtuar edhe disa konkluzione të Komisionit për disa pasuri, për të cilat në arsyetimin e vendimit rezulton e qartë se nuk janë përdorur prej tij si bazë për dhënien e masës disiplinore. Në këto kushte, trupi gjykues u fokusua në shqyrtimin dhe analizimin vetëm të shkaqeve të ankimit që u adresoheshin arsyeve të dhënies së masës disiplinore ndaj ankuesit, duke i konsideruar pa ndikim në zgjidhjen e çështjes shkaqet e ankimit për pasuritë: (i) tokë bujqësore me sipërfaqe 6540 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Konispol, Sarandë; (ii) apartament banimi me sipërfaqe 60,47 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Lushnjë, në pronësi të personit të lidhur të subjektit, znj. V. H.; (iii) autoveturë tip “Mercedes-Benz”, në pronësi të personit të lidhur të subjektit, znj. V. H.; (iv) ndërtesë dhe truall në Ksamil – pasi konkluzionet për këto pasuri nuk kanë shërbyer për Komisionin për vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

20. Në lidhje me pasurinë truall me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> dhe banesë me sipërfaqe 57,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në Konispol, deklaruar në pronësi të tij, subjekti kundërshton vlerësimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri.

21. Ky vlerësim u bazua nga Komisioni në konstatimet se: (i) krijohet bindja se kjo banesë (shtesa mbi ndërtesën ekzistuese) është rikonstruktuar dhe ndërtuar nga të ardhura të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që është edhe përfituesi i vetëm i kësaj pasurie pas vdekjes së prindërve, duke marrë edhe pjesët takuese të vëllezërve; (ii) prindërit e subjektit kanë qenë në pamjaftueshmëri financiare për ndërtimin dhe rikonstruksionin e kësaj banese; (iii) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit kanë shërbyer për të krijuar edhe pasuri të tjera gjatë kësaj periudhe; (iv) mbetet i paprovuar momenti i rikonstruksionit dhe ndërtimi i shtesës së katit, i cili duket se është bërë pa lejet përkatëse, por, referuar pamjeve të fotove, duket se ndërtimi nuk është shumë i hershëm.

22. Në këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

- i. Është provuar që kjo banesë është ndërtuar nga gjysh-stërgjyshërit e tij, ka qenë përherë e banuar, është restauruar ndër breza dhe ka qenë ekzistuese para viteve 1990, pra *nuk është ndërtuar nga subjekti*.
- ii. Restaurimi i banesës i bërë përpara viteve 2000, është kryer pjesë-pjesë, me materiale rrethimore të marra privatisht dhe punimet janë kryer nga të afërm e miq me kontribut vullnetar, dhe është kryer me të ardhurat nga kursimet e pagave, pensionet e prindërve, si dhe të ardhurat e krijuara nga ekonomia familjare.
- iii. Komisioni në mënyrë të padrejtë e ka konsideruar këtë pronë si të investuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, nisur nga fakti që kjo banesë është e regjistruar vetëm në emrin e tij dhe jo edhe në emrin e dy vëllezërve të tij.
- iv. Komisioni nuk ka njohur si të ardhura të ligjshme të ardhurat nga kursimet e pagave, pensionet e prindërve, si dhe të ardhurat e krijuara nga ekonomia familjare.

23. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga aktet e çështjes, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, ka deklaruar pasurinë *truall + shtëpi banimi, ndodhur në Konispol, e regjistruar në ZVRPP Sarandë me certifikatën për vërtetim pronësie dt.09.11.2011, ZK {\*\*\*}, nr. pas. {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, fq. {\*\*\*} me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> truall, nga kjo 57,3 m<sup>2</sup> ndërtesë. Kjo shtëpi ka një verandë rreth 20 m<sup>2</sup> dhe një depo rreth 20 m<sup>2</sup> në katin përdhes. Subjekti ka deklaruar se e ka përfituar pa pagesë, me trashëgim nga prindërit dhe pas heqjes*

dorë nga trashëgimia e vëllezërve A. H. dhe R. H., me pjesë takuese 100%. Sipas përshkrimit në deklaratë<sup>3</sup>, çmimi i shitjes në Konispol për një sipërfaqe të tillë varion rreth 2.500.000 lekë.

24. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003: *Shtëpi banimi e ndërtuar para vitit 1990, me sipërfaqe rreth 100 m<sup>2</sup>, pronë e nënës sime. Vlera 3 milionë lekë. Pjesa që zotëron: 50%. Shtëpi banimi në Konispol, e ndërtuar para viteve '90 nga prindërit e mi, pronë e nënës sime pasi 2 vëllezërit e tjerë që kam janë të martuar dhe të ndarë, me shtëpi më vete. Shtëpi fshati e trashëguar.*
25. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, për përcaktimin e momentit të rikonstruksionit dhe ndërtimit të shtesës së katit, nuk ka administruar ndonjë të dhënë nga shërbimet gjeohapësinore, të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse, por është bazuar kryesisht në vlerësimin e fotografive të ndërtesës të depozituara nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni ka pranuar në arsyetimin e vendimit objekt kontrolli se ky moment ngeli i paprovuar, por se nga fotografitë duket se ndërtimi nuk është shumë i hershëm dhe, si rrjedhojë, ka vlerësuar se ai është bërë nga subjekti i rivlerësimit, bazuar edhe në faktin se ai aktualisht është pronari i vetëm i saj.
26. Konstatohet se në pikën 2.11 të vendimit, Komisioni ka dalë në konkluzionin se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, por pa përcaktuar vlerën konkrete të kësaj mungese. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se gjetjet e Komisionit për këtë pasuri nuk janë bazuar në fakte të provuara, por ato kanë ngelur në nivelin e hipotezave logjike, për të cilat subjekti i rivlerësimit nga arsyetimi i vendimit nuk ka mundur të ketë qartësi në funksion të mbrojtjes së tij nëpërmjet ankimit dhe, si rrjedhojë, gjetjet e Komisionit nuk mund të kualifikohen sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
27. *Në lidhje me pasurinë truall me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup> për ndërtim banese, në rrugën “{\*\*\*}”, Sarandë, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit se trupi gjykues vlerëson se këto veprime bien ndesh me etikën dhe detyrën e subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi dhe se cenojnë figurën e prokurorit. Ai nuk ka deklaruar vlerën reale të kësaj pasurie (të rivlerësuar) në deklaratën “vetting”, duke e fshehur atë.*
28. Ky vlerësim i Komisionit u bazua në konstatimet se: (i) krijohet bindja se ky truall është përfituar për ndërtimin e një banese private për subjektin e rivlerësimit, por ky ka qenë thjesht një pretekst i deklaruar prej tij për përftimin e kësaj pasurie, pasi nuk ka përmbushur qëllimin për të cilin ishte përfituar, e se ai gëzonte një banesë, të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) si i pastrehë, më herët; (ii) shpjegimet e subjektit se kjo pasuri ishte në një zonë të vështirë e të pabanuar, nuk duken bindëse, pasi ai vetë ka aplikuar për marrjen e kësaj pasurie, duke pranuar blerjen e saj para noterit publik në Sarandë; (iii) subjekti ka rivlerësuar pronën në vitin 2011 me vlerësues privat dhe me një çmim të lartë, për qëllime të interesave të tij private apo të biznesit. Në vitin 2017, ka kryer sërish rivlerësim të kësaj pasurie, duke e kthyer këtë pronë në vlerën sipas çmimit të tregut, përcaktuar me akte nënligjore; (iv) mosdeklarimi në

---

<sup>3</sup> Sipas certifikatës familjare, në trungun familjar të kryefamiljarit H. H., në vitin 1991 ishin regjistruar H. H., D. H. dhe Artan Hazbi. Pas vdekjes së prindërve, H. H. më 25.1.2000 dhe D. H. më 18.5.2010, të dy vëllezërit A. dhe R. H. kanë hequr dorë nga pasuria e lënë si trashëgim nga prindërit tanë për shkak se ata kanë qenë familje më vete në vitin 1991, janë trajtuar me AMTP më vete dhe kanë ndërtuar banesat e tyre, në të dyja anët e banesës prindërore, në truallin që ka pasur babai që në vitin 1947. Çmimi i shitjes në Konispol për një sipërfaqe të tillë varion rreth 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë. Unë e kam përfituar pa pagesë. Pjesa takuese: 100%.

DPV i veprimeve të kryera me këtë pasuri, bëjnë të besueshëm faktin se subjekti ka fshehur vlerën reale apo ka kryer veprime të mundshme për tjetërsimin e kësaj pasurie, të cilat mbetën jashtë kontrollit nga ILDKPKI-ja ndër vite; (v) subjekti deklaroi se kjo është një pasuri modeste dhe e pavlerësuar, por në fakt rezultoi me një vlerë ekonomike të lartë, e cila ka shtuar disa herë pasurinë e subjektit të rivlerësimit të përfituar në mënyrë të padrejtë.

29. Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

- i. Trualli është përfituar me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë në vitin 1996, përpara se subjekti të ushtronte funksionin e prokurorit.
- ii. Është trajtuar njësoj si të gjithë personat e tjerë, në përputhje me ligjin, me çmim jopreferencial dhe pa asnjë abuzim.
- iii. Në këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk ka investuar për shkak të terrenit të vështirë dhe vendndodhjes në një zonë e cila më pas, me studimin e ri urbanistik, referuar Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë të miratuar me vendimin nr. 3, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, që ka hyrë në fuqi në datën 19.03.2018, u përcaktua si zonë e gjelbër, çka e bën vlerën e pronës 0 (zero) lekë, për shkak se kjo pasuri as nuk përdoret e as nuk tjetërsohet.
- iv. Fakti i përfitimit të pronës nga një organ shtetëror dhe tarifa e paguar për përfitimin e saj, duhet të çojnë Kolegjin në vlerësimin se mosdeklarimi i vlerës së rivlerësuar të kësaj pasurie në vitin 2011 në DIPP-2011 dhe në deklaratën *vetting* nuk ka qenë i qëllimshëm, por ka qenë thjesht një harresë dhe nuk duhet të trajtohet si fshehje. Rivlerësimi i pasurisë në vitin 2017 nuk ka qenë i qëllimshëm, por është bërë në kushtet e harresës së faktit të rivlerësimit të kryer në vitin 2011. Subjekti ka menduar se rivlerësimi i pasurisë do të deklarohet në momentin që do të investonte në të.
- v. Me blerjen e këtij trualli, nuk ka cenuar as etikën dhe as detyrën e tij.

30. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga aktet e çështjes, trupi gjykues konstaton se pasuria “truall” me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Sarandë, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*: *truall për ndërtim me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZVRPP Sarandë, me certifikatë për vërtetim pronësie datë 26.01.2016, Z.K {\*\*\*}, nr. pas {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, Sarandë. Trualli është përfituar në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 15.03.1996, të Këshillit Bashkiak. Me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.11.2001, lidhur përpara noterit publik A. A. në Sarandë, me palë shitëse Bashkia Sarandë dhe blerës Artan Hazbi, kjo sipërfaqe truall është blerë në shumën 146.880 lekë, me burim të ardhurash nga kursimet e mia dhe të familjes. Pjesa takuese 100%.*

31. Trupi gjykues, nga aktet e fashikullit të Komisionit, konstaton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.03.1996, të Këshillit të Bashkisë Sarandë, subjektit të rivlerësimit i është dhënë për shesh ndërtimi, parcela nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup>. Ky fakt është konfirmuar edhe prej subjektit të rivlerësimit, i cili, gjatë hetimit administrativ<sup>4</sup>, ka shpjeguar se trualli do të përdorej për të ndërtuar banesë private.

---

<sup>4</sup> Përgjigjet e pyetjeve 1 dhe 2, datë 23.12.2020, përgjigja për pasurinë truall 306 m<sup>2</sup>.

32. Në datën 22.12.1998, Këshilli i Rregullimit të Territorit Sarandë (në vijim “KRRT Sarandë”), ka dhënë në favor shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, lejen e ndërtimit nr. {\*\*\*} prot., datë 22.12.1998, të një objekti që do të finançohej nga subjekti i rivlerësimit.
33. Në vijim, më datë 11.11.2001, është lidhur ndërmjet Degës Ekonomike të Bashkisë Sarandë dhe subjektit të rivlerësimit, kontrata e shitjes së truallit me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup>, me çmimin 146.680 lekë. Ky veprim është formalizuar përpara noterit publik në Sarandë, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.11.2001. Kontratat e sipërcituara të shitblerjes së truallit referojnë si bazë ligjore, ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve”. Referuar nenit 3 të këtij ligji, subjekti do të konsiderohej i ligjshëm në përfitimin e këtij trualli me qëllim ndërtimi, nëse ai do të përmbushte njërin nga dy kriteret ligjore: (a) të ishte i pastrehë; (b) të ishte investitor i rëndësishëm. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti nuk ka qenë i pastrehë, pasi më herët, në vitin 1995, kishte përfituar një apartament të ndodhur në parkun e mallrave, Sarandë, përmes procesit të privatizimit me EKB-në (pasuri të cilën e ka shitur në vitin 1998). Brenda harkut kohor prej 1 viti (31.03.1995 - 15.03.1996), subjekti ka përfituar dy pasuri shtetërore, përkatësisht një apartament nga EKB-ja dhe një truall nga Këshilli Bashkiak Sarandë për ndërtim banese private.
34. Referuar ligjit të kohës nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i ndryshuar<sup>5</sup>, subjekti i rivlerësimit e ka rivlerësuar këtë pasuri në vitin 2011, në vlerën 5.195.574 lekë dhe, më pas, në bazë të ligjit të mëvonshëm nr. 81, datë 25.07.2016, “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, e ka rivlerësuar në vitin 2017 në vlerën 3.297.462 lekë. Pretendimi i subjektit se në vitin 2017, kur ka kryer rivlerësimin, nuk e mbante mend rivlerësimin e kryer më herët, në vitin 2011, është i pabesueshëm për trupin gjykues. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm vlerën sipas çmimit të paguar në vitin 2001, prej 146.800 lekësh.
35. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për blerjen e truallit objekt kontrolli, nuk plotësonte kërkesat e ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, pasi ai nuk ka ndërtuar realisht banesë në këtë truall. Pretendimi i subjektit se kthimi në zonë të gjelbër i zonës ku ndodhej trualli në fjalë, pamundësonte ndërtimin e një objekti nga ana e subjektit, rezulton i pambështetur, pasi kjo zonë është kthyer në zonë të gjelbër në vitin 2017, rreth 21 vite pas përfitimit të kësaj pasurie.
36. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, për këtë truall, është pajisur me certifikatën e pronësisë nr. {\*\*\*}, datë 26.01.2016. Kartela e pasurisë së paluajtshme<sup>6</sup> e pasurisë nr. {\*\*\*}, truall me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup>, në rubrikën “Përshkrim i veçantë”, ka shënimin: *Parcela nr. {\*\*\*} është regjistrim i parregullt*, ndërsa në seksionin “E” ka shënimin: *Në bazë të urdhrit të regjistruesit, mbi këtë pasuri u vendos masa e kufizimit*.

---

<sup>5</sup> Neni 27: “Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, brenda kohës së zbatimit të këtij ligji, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut”.

<sup>6</sup>Përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.10.2017, administruar në Komision me nr. {\*\*\*}-Prot., datë 09.10.2017 (dosja e ILDKPKI).

37. Referuar akteve<sup>7</sup> të fashikullit të Komisionit, rezulton se subjekti deri më datë 03.10.1998, ka ushtruar funksionin e oficerit të policisë gjyqësore dhe prej kësaj date, ka ushtruar funksionin e prokurorit. Trualli objekt vlerësimi, vërtet është përfitur në vitin 1996, kur subjekti nuk ka qenë me funksion prokuror, por përfitimi i tij nuk është një proces i filluar e i përfunduar brenda këtij viti, pasi pronësia mbi këtë truall i ka kaluar subjektit nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.11.2001, kohë në të cilën subjekti ka qenë me funksion prokuror.
38. Veprimet e kryera mbi këtë pasuri prej subjektit të rivlerësimit duke përfitur një truall për ndërtim banese pa gëzuar statusin si i pastrehë, duke mos ndërtuar realisht një banesë, për të vijuar më tej me rivlerësime të kësaj pasurie fillimisht duke i rritur vlerën, e më pas duke e ulur përsëri atë dhe mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i vlerës pas rivlerësimit, në kushtet kur nuk është evidentuar nga hetimi administrativ i Komisionit ndonjë veprim konkret i subjektit të rivlerësimit në kohën që ushtronte funksionin e prokurorit, për ndonjë ndikim të paligjshëm apo veprime në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të detyrës së tij, me qëllim përfitim të kësaj pasurie nga institucionet shtetërore, konsiderohen nga trupi gjykues si veprime të cilat nuk mund të ngrihen në nivelin e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr.84/2016. Por trupi gjykues çmoi që veprimet e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, të vlerësohen në kuadër të besueshmërisë së tij në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
39. *Në lidhje me pasurinë truall, me sipërfaqe 608 m<sup>2</sup>, rruga “{\*\*\*}”, Sarandë, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit se subjekti e ka përfitur këtë pasuri në mënyrë të padrejtë, pasi kishte përfitur edhe më herët pasuri të tjera publike si banor i Sarandës, si dhe ka fshehur vlerën reale të kësaj pasurie në deklaratën “vetting”, duke deklaruar atë të përfitim të saj në vitin 2002. Subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit, pasi ndërkohë që ushtronte funksionin si oficer i policisë gjyqësore dhe më pas, si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Sarandë, ka përfitur si investitor një pasuri publike dhënë me qëllim zhvillimin e qytetit dhe nuk ka kryer në vijimësi, në një hark kohor shumë të gjatë, asnjë investim në këtë pasuri, duke e trajtuar si pasuri private dhe krejtësisht për qëllime personale, e cila, pas rivlerësimit, ka shtuar disa herë vlerën e pasurive të subjektit të rivlerësimit. Komisioni i konsideron këto veprime të tilla që cenojnë figurën e tij si prokuror.*
40. Subjekti, lidhur me këtë shkak ankimi, pretendon se:
- i. E ka përfitur këtë pasuri në bazë të ligjit, pa asnjë privilegj, si të gjithë personat e tjerë.
  - ii. Mosdeklarimi i lejes së ndërtimit të marrë në vitin 2001 dhe i shumës së paguar nga ana e tij për këtë leje, ka ndodhur për shkak të harresës.
  - iii. Subjekti nuk ndodhet në kushtet e mosdeklarimit apo fshehjes të lejes së ndërtimit të miratuar në vitin 2010 e të zbardhur më datë 25.02.2011, sepse kontratën e sipërmarrjes dhe lejen e ndërtimit i ka deklaruar me DIPP-në e vitit 2012, kohë në të cilën u vu efektivisht në dijeni të kësaj leje ndërtimi.
  - iv. Rivlerësimi i pronës do të deklarohet në momentin që do të investohej tek kjo pasuri dhe se nëpërmjet paraqitjes së certifikatës së pronësisë për këtë truall, subjekti i rivlerësimit në mënyrë indirekte e ka deklaruar edhe rivlerësimin e pasurisë.

---

<sup>7</sup> Shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2016, të Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 06.10.1998, të Prokurorisë së Përgjithshme.

- v. Nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe aktiviteti i tij si investitor është në përputhje me Kushtetutën. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që çështjen e tij ta trajtojë në të njëjtën mënyrë si çështjen që i përket një tjetër subjekti rivlerësimi, me inicialet A.K., që është identik me rastin e tij.
41. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga aktet e çështjes, trupi gjykues konstaton se pasuria truall me sipërfaqe 608 m<sup>2</sup>, rruga “{\*\*\*}”, Sarandë, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*: *Truall për ndërtim me sipërfaqe 608 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZVRPP Sarandë, me certifikatë për vërtetim pronësie dt.05.01.2016, ZK {\*\*\*}, nr. pas. {\*\*\*}/\*\*\*, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, Sarandë. Trualli është përfitur në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, dt. 28.08.1999, të Këshillit Bashkiak. Me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.06.2002, lidhur përpara noterit publik A. A. në Sarandë, me palë shitëse Bashkia Sarandë dhe blerës Artan Hazbi, kjo sipërfaqe truall është blerë në shumën 291.840 lekë, me burim të ardhurash nga kursimet e mia dhe të familjes.*
42. Në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 28.8.1999, subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi i është miratuar sheshi i ndërtimit me sipërfaqe të përgjithshme 608 m<sup>2</sup>.
43. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Sarandë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2001, i ka dhënë subjektit ndërtues “{\*\*\*}” ShPK, leje ndërtimi për objektin “Hotel” në sheshin e ndërtimit të miratuar për subjektin e rivlerësimit Artan Hazbi. Kjo leje ndërtimi ka ngelur formale, pasi nuk rezulton që të jetë zbatuar.
44. Me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.06.2002, me palë shitëse Bashkia Sarandë dhe blerës Artan Hazbi, kjo sipërfaqe truall është blerë nga subjekti në shumën 291.840 lekë.
45. Kjo pasuri është rivlerësuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, në vlerën 11.893.088 lekë. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar vetëm çmimin e blerjes së truallit në vitin 2002, por nuk ka deklaruar vlerën e rivlerësuar të tij.
46. Në datën 09.05.2010, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., midis pronarit të truallit Artan Hazbi dhe znj. V. H. si investitore, për ndërtimin në këtë truall të një objekti “Godinë banimi dhe shërbimesh-garazh”, i cili do të kryhej nga shoqëria ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK. Në vijim, Bashkia Sarandë miratoi lejen e ndërtimit me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2010, zbardhur më datë 25.02.2011. Për shkak të pamundësisë financiare për të kryer këtë investim, znj. V. H. ka hequr dorë si investitore me kontratën e porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.03.2011 dhe, me pëlqimin e pronarit të truallit (subjektit të rivlerësimit), është bërë investitore dhe njëkohësisht ndërtuese shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e cila merri përsipër ndërtimin e objektit me mjetet e veta financiare dhe zbatimin e detyrimeve përkundrejt pronarit të truallit (subjektit të rivlerësimit) për dhënien e 30% të sipërfaqes ndërtimore në objektin që do të ndërtohej. Kjo shoqëri ka kryer fillimisht sistemimin e sheshit të ndërtimit dhe më pas, për mungesë fondesh, ka ndërprerë kryerjen e mëtejshme të investimit.
47. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010, kontratën e sipërmarrjes të datës 09.05.2010, nënshkruar me palën sipërmarrëse V. H., por e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, kur investitorja V. H. është zëvendësuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Në DIPP-në e vitit 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm faktin se ka përfitur një leje ndërtimi të miratuar nga Bashkia Sarandë, me shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK, e cila është

zbardhur në datën 25.02.2011. Subjekti ka deklaruar se investitore është znj. V. H. dhe se për mungesë të financimit nuk ka filluar ende ndërtimi. Në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar kontratën e porosisë të lidhur më datë 04.03.2011 dhe as faktin që investitore është bërë shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Marrëdhënia me firmën e ndërtimit deklarohet në DIPP-në e vitit 2012.

48. Me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.10.2016, nënshkruar ndërmjet shtetasve V. H., Artan Hazbi dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, është deklaruar se në truallin në fjalë nuk është bërë asnjë investim për shkak të mungesës së financimit, si dhe të skadimit të lejes së ndërtimit dhe se të gjitha shpenzimet për bërjen e investimit janë përballuar nga sipërmarrësi “{\*\*\*}” ShPK, si investitor i këtij ndërtimi.
49. Në datën 29.03.2017, është hartuar deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., nëpërmjet së cilës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga administratori i saj, z. G. K., ka deklaruar se heq dorë nga investimi në truallin në pronësi të z. Artan Hazbi, duke kthyer palët në gjendjen fillestare pa asnjë kusht (referuar deklaramentit të subjektit të rivlerësimit në DIPP 2017).
50. Komisioni nuk evidenton në arsyetimin e vendimit ndonjë veprim të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës për ndikim të padrejtë ndaj institucioneve shtetërore lidhur me përfitimin e këtij trualli, apo të ketë pasur në hetim ndonjë procedim penal ndaj strukturave të Bashkisë Sarandë ku të ketë kryer veprime a mosveprime të padrejta e favorizuese, duke përfituar në këmbim pasurinë truall dhe lejet e dhëna për zhvillimin e tij. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se vetëm fakti i përfitimit të truallit me qëllim kryerjen e një ndërtimi, nuk është një situatë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
51. Sa më sipër argumentuar, në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se veprimet e subjektit lidhur me këtë pasuri, nuk mund të ngrihen në nivelin e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por ato u vlerësuan në kuadër të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në vlerësimin e pasurisë në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
52. Në lidhje me pasurinë *apartament banimi me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, Sarandë*, subjekti kundërshton vlerësimin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë. Transaksionet e kryera me këtë pasuri ishin të dyshimta [blerë në vitin 2007 për vlerën 1.800.000 lekë, rivlerësuar në vitin 2017, në vlerën 65.065 euro dhe këmbyer me një pasuri truall + hotel në Ksamil], duke krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarament të rremë, ndër vite, duke fshehur vlerën reale të investimit për këtë pasuri, si dhe ndodhet në mungesë të burimeve financiare të ligjshme.*
53. Ky vlerësim i Komisionit u bazua në konstatimet se:
  - i. Çmimi i blerjes, në vlerën 1.800.000 lekë, është dukshëm më i ulët se çmimet referuese të shitblerjes së pronave në vitin 2007 në qytetin e Sarandës dhe, sipas vlerave referuese të EKB-së, megjithëse apartamenti ndodhej në qendër të qytetit (sipas deklarimeve edhe të subjektit kur e ka këmbyer atë), në një zonë të mirë dhe situatë të favorshme. Pasuria ka qenë e regjistruar dhe nuk ka pasur arsye përse të shitej ndjeshëm nën çmimin e referencës, duke qenë se ishte edhe një ndërtim i ri. Çmimi i rivlerësuar në vitin 2017 është në vlerën

65.065 euro, çka tregon se kjo pasuri ka pasur një vlerë tregtare të mirë, e provuar kjo edhe me këmbimin e saj me pasurinë truall + ndërtesë/hotel në Ksamil.

- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar, në vijim, asnjë shpenzim që të ketë rritur vlerën e kësaj pasurie, ndër vite (pa marrë në konsideratë edhe amortizimin natyral që ajo ka pasur), pavarësisht se është pyetur disa herë nga Komisioni.
- iii. Subjekti ka qenë në pamundësi financiare në vitin 2007, për blerjen e kësaj pasurie në vlerën e deklaruar prej 1.800.000 lekësh, po ashtu të pajustificuara mbeten edhe shpenzimet për investime të mundshme të kryera, të cilat mund të kishin shtuar vlerën e saj. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka blerë një banesë me defekte të dukshme, e cila kishte mbetur pa shitur, por nga ana tjetër nuk e shoqëron këtë arsyetim me kosto reale shpenzimesh apo ndonjë dokumentacion provues.

54. Lidhur me këtë shkak ankimi subjekti i rivlerësimit pretendon se:

- i. Kjo banesë është blerë me çmim më të ulët, por të pranuar nga palët, për shkak të defektit në rrjetin e ujit, të cilin subjekti i rivlerësimit e ka rregulluar vite më vonë, në mënyrë private. Pas rivlerësimit, apartamentit iu rrit vlera për shkak të rregullimit të defektit, gjendjes së mirë të banesës, faktit që ishte banesë e pabanuar, në qendër të qytetit, në një kat të mirë.
- ii. Ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, por nga ana e Komisionit nuk janë marrë në konsideratë: i) pensioni i nënës së tij; ii) të ardhurat në shumën 250.000 lekë të përfituara në vitin 2006 nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”; iii) kursimet në vlerën 500.000 lekë në vit nga rroga vjetore, e cila ia ka krijuar këtë nivel kursimi, për shkak se nga kjo rrogë ai shpenzonte vetëm për ushqim dhe veshmbathje dhe nuk kishte shpenzime të tjera.
- iii. Subjekti nuk ka kryer asnjëherë deklaram të rremë në lidhje me këtë pasuri.

55. Rezulton se pasuria apartament banimi me sipërfaqe ndërtimi 77 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, Sarandë, blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting me përshkrimin: *apartament banimi me sipërfaqe ndërtimi 77 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*}, k. {\*\*\*}, lagjja nr. {\*\*\*}, me nr. pasurie {\*\*\*}, z. k. {\*\*\*}, Sarandë, blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.6.2007, lidhur në Sarandë, përpara noterit publik. Blerë në shumën 1.800.000 lekë, me burim të ardhurat nga kursimet e subjektit dhe të familjes.*

56. Trupi gjykues konstaton se, referuar udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 04.04.2007, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit “K”, për vitin 2007”, rezulton se çmimi i shitjes lekë/m<sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi për tregun e lirë në qytetin e Sarandës, është 50.537 lekë/m<sup>2</sup>. Në bazë të këtij udhëzimi, çmimi i shitjes së apartamentit objekt shqyrtimi, është 3.891.349<sup>8</sup> lekë, vlerë e cila rezulton e llogaritur saktë nga Komisioni. Kjo vlerë rezulton 2,16 herë më e lartë se çmimi i blerjes nga subjekti, prej 1.800.000 lekësh. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit se çmimi i blerjes nuk është në përputhje me tregun dhe se subjekti është favorizuar në blerjen e apartamentit objekt vlerësimi. Nga analizimi i kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, nr.

---

<sup>8</sup> Llogaritur 77 m<sup>2</sup> x 50.537 lekë/m<sup>2</sup>.

{\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.06.2007, konstatohet se në të nuk ka ndonjë përshkrim për defekte apo të meta të pronës, në kundërshtim me sa pretendon subjekti.

57. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova për kryerje punimesh për riparime në këtë apartament, që mund të rrisnin vlerën e pasurisë apo të justifikonin pretendimin e subjektit lidhur me çmimin e ulët të blerjes së saj. Ky defekt edhe sikur të merret i mirëqenë se ka ekzistuar, riparimi i tij nuk mund ta kishte vlerën më të madhe se çmimi i blerjes së vetë apartamentit.
58. Trupi gjykues kontrolloi analizën financiare të Komisionit lidhur me mundësinë e subjektit për blerjen me burime financiare të ligjshme të apartamentit objekt shqyrtimi, duke iu referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e përcjellë nga Komisioni. Nga kjo analizë, rezultoi se subjekti, pas përfshirjes së të ardhurave të nënës nga pensioni, ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme të shoqëruar me dokumentacion për krijimin e kësaj pasurie dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, në masën (-) 287.722 lekë.
59. Lidhur me pretendimin për përfshirjen në analizën financiare edhe të çmimit të shitjes së automjetit “Mercedes Benz” në vitin 2006, në shumën 250.000 lekë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë vlerësimin e Komisionit për mospranimin e këtyre të ardhurave, referuar deklaratimeve të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, sipas të cilave ai nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje në fund të vitit.
60. Subjekti i rivlerësimit pretendon se niveli i shpenzimeve të jetesës ka qenë më i ulët nga ai i përlogaritur nga Komisioni pasi ai shpenzonte vetëm për ushqim dhe veshmbathje dhe nuk kishte shpenzime të tjera. Për rrjedhojë, nga paga e tij ka kursyer më shumë se 500.000 lekë në vit. Ky pretendim i subjektit vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar në deklaratat periodike për vitet 2003 – 2006, në të cilat subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*, ndërsa ndryshimet në likuiditete në sistemin bankar janë përfshirë në analizë.
61. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka kryer asnjëherë deklaram të rremë në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues vëren se në pikën 5.13 të vendimit objekti shqyrtimi, Komisioni vlerëson se i është krijuar bindja që subjekti i rivlerësimit ka fshehur vlerën reale të investimit për këtë pasuri dhe ka kryer deklaram të rremë ndër vite. Nga aktet e fashikullit të çështjes, rezulton se në deklaratën *vetting* dhe DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar si vlerë shitjeje, atë prej 1.800.000 lekësh, të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, duke u përputhur kështu deklarami me kontratën e shitblerjes.
62. Trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur nga hetimi administrativ i Komisionit nuk janë gjetur prova bindëse për pavërtetësinë e të dhënave të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, vetëm fakti i mospërputhjes së çmimit të blerjes të përcaktuar në kontratë, me atë të përcaktuar si referencë nga EKB-ja, nuk është i mjaftueshëm për ta klasifikuar këtë situatë faktike si deklaram të rremë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016. Vetë Komisioni, në analizën financiare të subjektit, këtë pasuri e ka pasqyruar në vlerën 1.800.000 lekë sipas kontratës së shitjes.
63. Në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkakui të ankimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

64. Në lidhje me pasurinë *apartament 1+1, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup> + sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup>*, të ndodhur tek ish-parku i mallrave, Sarandë, përfituar në vitin 1995, me proces privatizimi nga EKB-ja, subjekti kundërshton konkluzionet e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë fitimin e pronësisë mbi truallin me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> dhe nuk ka provuar pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në vitin 1998. Veprimet e kryera prej tij, duke e shitur këtë pasuri të përfituar për qëllim banimi dhe përfitimi më pas edhe të pasurive të tjera me statusin si i pastrehë, janë veprime që cenojnë etikën dhe figurën e prokurorit. Gjithashtu, ankuesi kundërshton edhe konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ishte në pamundësi financiare për të krijuar këtë pasuri në vlerën (-) 50.881 lekë.*
65. Ky vlerësim i Komisionit u bazua në konstatimet se:
- (i) Subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë përfituar në vitin 1995, nga EKB-ja, nëpërmjet procedurave të privatizimit të banesave, apartamentin 1+1, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, mbështetur në statusin e qiramarrësit të kësaj prone. Më tej, subjekti rivlerësimit e ka shitur këtë pasuri së bashku me truallin në vitin 1998, me një çmim shumë herë më të lartë dhe duke përfituar në vijim, pasuri të tjera në Sarandë me statusin i pastrehë.
  - (ii) Duket se subjekti ka blerë në vitin 1995 vetëm apartamentin me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, pasi shitja e trojeve nuk është kompetencë e EKB-së. Fitimi i pronësisë së truallit me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, mbetet i paprovuar dhe i padokumentuar.
  - (iii) Subjekti ishte në pamundësi financiare për të krijuar këtë pasuri në vlerën (-) 50.881 lekë.
66. Këtë shkak ankimi, subjekti e bazon në pretendimet si më poshtë.
- i. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme, pa marrë në konsideratë dy pensionet e pleqërisë së prindërve të tij dhe pagën e tij si oficer i policisë gjyqësore.
  - ii. Kompetenca e EKB-së për shitjen ose jo të trojeve, nuk është çështje që i përket subjektit. Si blerës, subjekti ka qenë përgjegjës vetëm për kryerjen e pagesave përkatëse në bazë të mandatit të hartuar nga përfaqësuesit e EKB-së Sarandë. Subjekti ka përmbushur detyrimet e veta, duke likuiduar çmimin.
  - iii. Subjekti nuk ka pasur detyrimin për të paguar tatimin nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme, pasi vlera e shitjes në rastin e tij, nuk e kalonte vlerën 2.000.000 lekë, të përcaktuar në ligjin e vitit 1998, si kufi minimal për lindjen e detyrimit të pagimit të tatimit nga shitja e pasurive të paluajtshme. Edhe nëse do të tatohej, detyrimin për mbajtjen e tatimit mbi këto të ardhura nuk e kishte subjekti, por ish-ZVRPP Sarandë.
  - iv. Shitja e pasurisë disa herë më shtrenjtë se blerja e saj, nuk mund të penalizojë subjektin pasi ajo është bërë në bazë të kërkesë/ofertës dhe çmimi i shitjes ka qenë i dakordësuar nga palët. Trojet e përfituara për ndërtim nga Këshilli Bashkiak Sarandë, nuk janë marrë me statusin si i pastrehë. Subjekti nuk ka cenuar etikën dhe figurën e prokurorit.
67. Nga aktet e fashikullit të Komisionit, rezulton se pasuria *apartament 1+1, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup>*, e ndodhur tek ish-parku i mallrave, Sarandë, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting: Me kontratën e shitblerjes dt. 31.03.1995, nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., lidhur para noterit publik, kemi privatizuar nga Enti Kombëtar i Banesave, me kursimet e mia dhe të familjes, një apartament 1+1, së bashku me një sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup> të ndodhur te parku i mallrave Sarandë, në shumën 72.000 lekë. Me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., dt. 18.02.1998, këtë apartament së bashku me*

*truallin e kemi shitur në vlerën 3.750.000 dhrahmi greke. 3.750.000 dhrahmi greke x 500 lekë = rreth 1.875.000 lekë. Pjesa takuese: Unë dhe prindërit 100%.*

68. Lidhur me pretendimin e subjektit se konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme, është rrjedhojë e mosmarrjes në konsideratë të pensioneve të pleqërisë së prindërve të tij dhe pagës së tij si oficer i policisë gjyqësore, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në arsyetimin e vendimit, nuk e ka pasqyruar analizën financiare që e ka çuar në këtë konkluzion. Nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, u krye në Kolegj analiza financiare lidhur me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1995. Në kushtet kur Komisioni nuk ka arritur të sigurojë informacion lidhur me të ardhurat e subjektit nga paga, pasi institucionet punëdhënëse kanë konfirmuar nëpërmjet vërtetimeve të administruara në dosje se nuk disponojnë të dhëna për shkak të djegies së arkivave gjatë vitit 1997, llogaritja e pagave për periudhën 1993 – 1995<sup>9</sup>, për efekt analize, është kryer në mënyrë alternative, duke iu referuar ligjeve<sup>10</sup> dhe VKM-ve përkatëse për pagat e gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve<sup>11</sup> për këtë periudhë. Në llogaritje janë konsideruar pagat mujore bruto, për të përjashtuar çdo gabim të mundshëm gjatë përlllogaritjes së pagave neto. Duke konsideruar të ardhurat që mund të ketë përfituar subjekti të llogaritura si më lart, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1995 dhe kryerjen e shpenzimeve.
69. Lidhur me pretendimin e ankuesit se kompetenca e EKB-së për shitjen ose jo të truallit nuk është çështje që i përket subjektit, trupi gjykues vëren se kjo pasuri nuk ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, pasi rezultoi e shitur prej tij dhe prindërve në cilësinë e bashkëpronarëve që në datën 18.02.1998. Si pasojë, analizimi i kësaj pasurie ka rëndësi për procesin e rivlerësimit të subjektit vetëm lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara prej tij në funksion të analizës financiare për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve dhe, si pasojë, çështja e privatizimit të truallit të kësaj banese, për sa kohë nuk është lidhur nga Komisioni me ndonjë veprim apo ndikim të kundërligjshëm të subjektit të rivlerësimit ose ndonjë trajtim preferencial, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk ka ndikim në zgjidhjen e çështjes.
70. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk ka pasur detyrimin për të paguar tatimin nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme, pasi vlera e shitjes në rastin e tij, nuk e kalonte vlerën 2.000.000 lekë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi në vitin 1998, si kufi minimal për lindjen e detyrimit të pagimit të tatimit nga shitja e pasurive të paluajtshme dhe se edhe nëse do të tatohej, detyrimin për mbajtjen e tatimit mbi këto të ardhura nuk e kishte subjekti, por ish-ZVRPP Sarandë, trupi gjykues analizoi legjislacionin e kohës. Rezulton se në datën 18.02.1998 të shitjes së kësaj pasurie, ka qenë në fuqi ligji nr. 8189, datë 30.01.1997, sipas të cilit të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme me vlerë deri në 2 milionë lekë nuk tatoheshin.

<sup>9</sup> (i) Llogaritja është kryer nga viti 1993, duke qenë se, sipas vlerësimit të Kolegjit, para vitit 1993 shpenzimet janë pothuajse të barabarta me të ardhurat; (ii) të ardhurat nga viti 1996 janë konsideruar sipas llogaritjes së Komisionit.

<sup>10</sup> Ligji nr. 7668, datë 02.02.1993, "Për pagat e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe hetuesve", si dhe ligji nr. 7800, datë 02.03.1994, "Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe hetuesve".

<sup>11</sup> Gjatë viteve 1993 – 1995, subjekti ka ushtruar funksionin e hetuesit/OPGj-së. Paga për këtë periudhë, e llogaritur në Kolegj sipas ligjit, rezultoi 321.600 lekë, nëse konsiderojmë edhe muajin janar 1993 me pagë bruto 4.000 lekë.

Me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.2.1998, subjekti e ka shitur këtë apartament së bashku me truallin në vlerën 3.750.000 dhrahmi greke. Bazuar në kursin e këmbimit të kohës, rezulton se çmimi i shitjes ka qenë nën kufirin e tatueshëm prej 2 milionë lekësh. Për rrjedhojë, gjendet i drejtë pretendimi i subjektit se nuk ka pasur detyrim për të paguar tatimin nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme.

71. Lidhur me pretendimin e subjektit se shitja e pasurisë disa herë më shtrenjtë se blerja e saj, nuk mund të penalizojë subjektin pasi çmimi është përcaktuar në bazë të kërkesë/ofertës dhe ka qenë i dakordësuar nga palët, vlerësohet i drejtë nga trupi gjykues. Si pasojë e analizës së mësipërme, gjendet i pabazuar konstatimi i Komisionit se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, janë veprime që cenojnë etikën dhe figurën e prokurorit.
72. *Në lidhje me gjendjen jashtë sistemit bankar, në formën “cash”, në shumën 210.000 lekë, të deklaruar në deklaratën vetting me burim krijimi nga kursimet e tij dhe të familjes, si dhe shitja e ullinjve për vaj, subjekti e vlerëson të gabuar dhe të njëanshëm qëndrimin e Komisionit se nuk janë konsideruar në analizën financiare të ardhurat nga shitja e ullinjve për vaj sepse nuk kanë dokumentacion ligjor të rregullt. Lidhur me këtë deklaram të subjektit, ai është vlerësuar në kuadër të analizës financiare.*
73. Në këtë shkak ankimi, subjekti pretendon se: (i) ashtu si të ardhurat nga paga, edhe fitimet nga shitja e ullinjve janë burime të ligjshme, ato janë fitime minimale dhe janë përdorur për shërbimet që u janë kryer ullinjve dhe jo për qëllime të tjera; (ii) pavarësisht mosdeklarimit të faturave nga subjekti Artan Hazbi, për shkak se ai nuk ishte i licencuar si subjekt tregtar, faturat janë deklaruar gjatë vitit 2016 nga subjekti blerës A. G., i cili është i regjistruar në organet tatimore; (iii) në këtë rast, Komisioni ka mbajtur një qëndrim me dy standarde, pasi në rastet e subjekteve të tjera të rivlerësimit, prindërit e të cilëve kanë pasur tokë bujqësore dhe kanë kryer veprimtari të tillë, i ka konsideruar të ligjshme të ardhurat e mbajtura në formë *cash*, të përfituara nga këto veprimtari.
74. Nga analizimi i akteve të çështjes, trupi gjykues e vlerëson të pambështetur në dokumentacion, pretendimin e subjektit për të ardhura të realizuara nga shitja e ullinjve gjatë viteve 2013-2015. Konkretisht, referuar aktit “Dokument projekti” për ngritjen e ullishtës, hartuar nga agronomja V. L., rezulton se në muajin prill 2011, janë mbjellë 210 rrënjë ullinj, të cilët do të hynin në prodhim në vitin 2016. Ky dokument tregon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur prodhim të ullinjve për vitet 2013, 2014, 2015 e, për rrjedhojë, nuk mund të ketë realizuar të ardhura nga shitja e tyre deri në vitin 2015. Ndërsa për shitjet e pretenduara të realizuara në vitin 2016, subjekti ka depozituar disa dëftesa të thjeshta tatimore<sup>12</sup>, duke shpjeguar se, në bazë të ligjit për shitjen e prodhimeve bujqësore, prodhuesi/shitësi (fermer) përjashtohet nga detyrimi për pagim tatimi, madje rimburohet, prandaj subjekti nuk ka paguar tatim. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë regjistruar si fermer në organet tatimore dhe, si rrjedhojë, ai nuk disponon dokumentacion ligjor që të justifikojë shitjet e pretenduara.
75. Nga sa më sipër argumentuar, bazuar edhe në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë

---

<sup>12</sup> Dëftesat tatimore të datave 12.11.2016 - 13.11.2016; 19.11.2016; 26.11.2016 - 29.11.2016; 17.12.2016 - 18.12.2016; 24.12.2016 - 25.12.2016.

qëndrimin e Komisionit për të mos konsideruar në analizë financiare, të ardhurat e pretenduara të përfituara nga shitja e ullinjve për vaj, pasi nuk u provua që në vitet 2011 – 2015, subjekti ka pasur prodhim e për pasojë as shitje, ndërsa për vitin 2016, nuk u vërtetua me dokumentacion ligjor të rregullt, ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara si të realizuara nga shitja e ullinjve.

76. Në lidhje me aktivitetin e kultivimit të ullinjve, subjekti e konsideron të padrejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë figurën e tij si prokuror.
77. Ky vlerësim i Komisionit u bazua në konstatimet se: (i) subjekti ka kryer aplikimin pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe ka përfituar nga subvencionet shtetërore, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; (ii) subjekti duket se e ka kryer këtë veprimtari në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës, si dhe me funksionin e tij si prokuror; (iii) duket se subjekti i rivlerësimit ka fshehur këtë veprimtari nga deklaratimet periodike vjetore, duke iu shmangur kështu kontrollit të ligjshmërisë; (iv) lidhur me të ardhurat e deklaruara nga shitja e prodhimitarisë bujqësore (ullinj) në shumën 685.500 lekë, subjekti ka paraqitur fatura shitjeje në shumën 321.300 lekë, por ndërkohë nuk është i regjistruar si subjekt tregtar.
78. Në këtë shkak ankimi, subjekti pretendon se: (i) ky aktivitet nuk është kryer në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pasi nuk është veprimtari ekonomike fitimprurëse dhe nuk është dypunësim për subjektin e rivlerësimit; (ii) subvencionin në vlerën 153.000 lekë, nuk është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, por është përfituar në mënyrë të ligjshme si fermer. Ka qenë organ tjetër që ka vendosur për këtë gjë dhe jo subjekti; (iii) nuk ka kryer fshehje të kësaj veprimtarie, pasi e ka deklaruar si në DIPP-në e datës 09.03.2012 dhe në deklaratën *vetting*; (iv) veprimtaria është e ligjshme dhe, për këtë arsye, të ardhurat e rrjedhura prej këtij aktiviteti, duhet të merren në konsideratë në analizën financiare.
79. Rezulton se aktiviteti i kultivimit të ullinjve është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*: *Në vendin e quajtur “{\*\*\*}”, vëllai im R. H., sipas AMTP nr. {\*\*\*} ka një sipërfaqe toke prej 1.800 m<sup>2</sup>. Për efekt dokumentacioni, këtë sipërfaqe ma ka dhënë me qira, siç i kam dhënë edhe unë me qira 2.900 m<sup>2</sup> tokë arë, ndodhur në Bllokun {\*\*\*}, parcela {\*\*\*}, e më pas i kemi shkëmbyer me marrëveshje verbale duke hequr dorë nga qiraja reciproke. Nuk i kemi marrë lekë njëri-tjetrit prandaj nuk janë deklaruar. Në vendin e quajtur “{\*\*\*}”, në mars 2011 unë kam mbjellë 210 rrënjë ullinj të rinj. Ata janë të regjistruar në Drejtorinë e Bujqësisë Sarandë. Për mbjelljet e reja që kam kryer, të cilat vërtetohen edhe me projektin i cili është aplikuar dhe miratuar nga Drejtoria e Bujqësisë Rrethit Sarandë, jam subvencionuar nga AZHBR në shumën rreth 152.000 lekë, të cilat m’i kanë kaluar nëpërmjet bankës Societe Generale Albania, sipas ekstraktit dt.22.2.2016 të kësaj banke më dt.17.10.2011 dhe 30.11.2011. Nga viti 2013 deri në vitin 2016, unë kam krijuar fitime në shumën rreth 70.500 + 190.000 + 205.000 + 220.000 lekë = 685.500 lekë.*
80. Në lidhje me subvencionin e përfituar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se: Ligji nr. 9817/2007, në nenin 7, pika “a”<sup>13</sup>, përcakton si përfitues të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ndër të tjerë, edhe fermerët. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i

<sup>13</sup> Neni 7: “Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave që ndërmerren në kuadër të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, janë: a) fermerët, grupet e fermerëve, personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë veprimtari

rivlerësimit ka depozituar formularin e aplikimit pranë Drejtorisë së Bujqësisë Sarandë për mbjellje të reja (formulari {\*\*\*}) datë 06.03.2011, të cilin e ka plotësuar me statusin e aplikantit “fermer individual”. Ky formular përmban një rubrikë e cila duhej plotësuar nga ana e subjektit me kodin e fermës dhe NIPT-in përkatës, çka dëshmon detyrimin për regjistrimin e fermës dhe pajisjen me NIPT. Mosplotësimi i kësaj rubrike nga ana e subjektit, dëshmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i regjistruar si fermer. Subjekti i rivlerësimit në këtë periudhë, ndërkohë që ka qenë i punësuar me funksion prokuror, në kundërshtim me këto përcaktime, është sjellë si fermer, duke përfituar në mënyrë të padrejtë nga fondi i programit për bujqësinë nëpërmjet subvencionimit. Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e këtij subvencioni (në konsideratë edhe të vlerës së vogël), nuk mund të ngrihen në nivelin e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por ato duhet të vlerësohen në kuadër të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në vlerësimin e pasurisë në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

81. *Në lidhje me shumën 860.000 lekë, të kaluara në llogarinë bankare të subjektit nga ana e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Sarandë, subjekti e kundërshton vlerësimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaramin periodik vjetor, duke fshehur këtë transfertë dhe qëllimin e kryerjes së saj, nga hetimi dhe kontrolli që kryente ILDKPKI-ja.*
82. Ky vlerësim i Komisionit është bazuar në konstatimet se: (i) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 transfertën nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën 860.000 lekë dhe qëllimin e përdorimit të saj, duke e fshehur këtë veprim e duke iu shmangur kontrollit mbi ligjshmërinë; (ii) deklaramet e subjektit “për mospasjen dijeni të këtij veprimi” në llogarinë e tij, nuk janë bindëse për Komisionin pasi ai vetë, me prezencën e tij, ka çelur llogari depozitë me këto fonde.
83. Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk duhet të penalizohet pasi: (i) nuk ka pasur dijeni mbi kalimin në llogari të tij, më datë 29.12.2006, të shumës 860.000 lekë nga ana e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK e, për rrjedhojë, nuk e ka pasqyruar këtë fakt në DIPP-në e këtij viti; (ii) nuk ka kryer fshehje, pasi këtë shumë nuk e ka përdorur, por e ka kthyer mbrapsht, fakt ky i deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2007.
84. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit në pikën 10.7 të vendimit objekt kontrolli, për deklaram të pasaktë të subjektit të rivlerësimit në deklaramin periodik vjetor për vitin 2006, lidhur me mosdeklaramin e këtij transaksioni bankar i cili nuk rezulton të ketë pasur asnjë efekt në analizën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve nga subjekti i rivlerësimit, konsiderohet pa peshë në zgjidhjen e çështjes dhe pa pasojë për vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin.
85. *Në lidhje me aktivitetin e mbarështimit të lopëve, të bashkëjetueses V. H., subjekti e konsideron të padrejtë vlerësimin e Komisionit se personi i lidhur ka vepruar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi dhe se nuk justifikohet krijimi i kësaj pasurie me burime të ligjshme.*

---

*bujqësore ose veprimtari ekonomike të lidhur me të; b) personat fizikë apo juridikë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë në industrinë agroushqimore; c) personat fizikë apo juridikë, të cilët ofrojnë shërbime për veprimtari bujqësore dhe veprimtari të tjera rurale”.*

86. Ky vlerësim i Komisionit është bërë bazuar në konstatimet se: (i) bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit deklaroi se burim krijimi për këtë aktivitet, kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet e saj, të cilat janë dhuruar nga prindërit para bashkëjetesës, por ajo nuk ka mundur të provojë se të ardhurat e pretenduara e kanë burimin nga dëmshpërblimi për ish-të përndjekurit politikë të përfituara nga prindërit e saj; (ii) lidhur me kontratën e qirasë, datë 12.8.2013, me afat 3-vjeçar, me qiradhënë Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Sarandë dhe qiramarrëse V. H., referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe rrethi i personave të lidhur me të, nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike. Çdo kontratë e lidhur me institucione publike nga data 03.06.2014, është në shkëlqje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, pas datës 03.06.2014, duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur situatën e konfliktit të interesave; (iii) subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi.

87. Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

- i. Veprimtaria e mbarështimit të lopëve ka qenë e ligjshme, gjithashtu të ligjshme ishin dhe të ardhurat e krijuara prej saj.
- ii. Burimi i krijimit ka qenë i ligjshëm, pasi janë përdorur të ardhurat e dhuruara nga babai i bashkëjetueses, të përfituara nga dëmshpërblimi për ish-të përndjekurit politikë.
- iii. Subjekti dhe bashkëjetuesja e tij nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit, pasi kontrata e qirasë për kullotat ishte lidhur përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit për “Parandalimin e konfliktit të interesit” dhe përpara fillimit të bashkëjetesës.
- iv. Për të shmangur konfliktin e mundshëm të interesit, nga ana e bashkëjetueses së tij, u morën masa të menjëhershme për të hequr dorë nga kontrata e qirasë për kullotën duke mos e rinovuar atë.

88. Rezulton se aktiviteti i mbarështimit të lopëve, sipas deklaramit në deklaratën *vetting*<sup>14</sup>, ka filluar të ushtrohet nga bashkëjetuesja e subjektit në datën 31.12.2012, me blerjen e 25 krerëve lopë dhe ka përfunduar në datën 22.08.2016, të lidhjes së kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me të cilën është realizuar shitja e pasurisë së luajtshme bagëti (25 krerë lopë dhe 18 viça).

---

<sup>14</sup>Në deklaratën “vetting”, bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “Të ardhura neto nga mbarështimi i 25 krerëve lopë, blerë në datën 31.12.2012, në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., lidhur përpara noterit publik, pasuri e cila është regjistruar në Drejtorinë e Bujqësisë Sarandë. Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Sarandë, është lidhur edhe kontrata e qirasë nr. {\*\*\*}, datë 12.8.2013, për marrjen me qira për kullotje dhe kositje bari të një sipërfaqeje 35 ha, me afat 3 vjet. Nga mbarështimi i këtyre lopëve deri më 31.12.2015, janë krijuar të ardhura neto: në vitin 2013, në vlerën 294.000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë; në vitin 2014, në vlerën 1.248.000 (një milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë) lekë; dhe në vitin 2015, në vlerën 704.000 (shtatëqind e katër mijë) lekë”. Vijon deklarimi: “Të ardhura neto të krijuara nga shitja e pasurisë së luajtshme (bagëti), sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.08.2016, lidhur para noterit publik, në shumën 2.415.000 lekë. Janë shitur 25 krerë lopë dhe 18 viçat e tyre, të cilat blerësi i ka marrë në dorëzim që në datën 01.01.2016 dhe pagesën e ka bërë me tri këste të barabarta në fund të muajve gusht, shtator dhe tetor 2016. Një pjesë e lekëve të fituara nga shitja e bagëtive dhe konkretisht shuma 2.400.000 lekë, është investuar prej meje te Fondi i Investimit në RFZ Bank më datë 30.11.2016, me një afat 1-vjeçar për blerje kuotash”.

89. Lidhur me pretendimet e ankuesit, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka kontestuar ligjshmërinë e regjistrimit të këtij aktiviteti. Konstatohet se regjistrimi i fermës së lopëve është bërë në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. Ky konstatim bazohet në vërtetimin e datës 17.03.2015, të Degës së Bujqësisë Sarandë, depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *vetting*, i cili vërteton faktin që ferma blegtorale ka qenë e regjistruar në zyrën veterinarë Sarandë.
90. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura neto të realizuara nga ky aktivitet gjatë periudhës 2013-2016, në shumat respektive: 294.000 lekë në vitin 2013; 1.248.000 lekë në vitin 2014; 704.000 lekë në vitin 2015 dhe shumën 2.415.000 lekë, përfituar nga shitja e pasurisë së luajtshme (bagëti), në vitin 2016. Referuar pikës 3.9 (faqe 24) të vendimit objekt shqyrtimi, këto të ardhura nuk janë njohur nga Komisioni si të ligjshme. Ky qëndrim i Komisionit u vlerësua nga trupi gjykues në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, si edhe praktikën e konsoliduar<sup>15</sup> të Kolegjit, të cilat përkufizojnë si të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat e deklaruara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezultoi se subjekti/bashkëjetuesja dështoi të provonte me dokumentacion ligjor qoftë likuidimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e pretenduara nga kjo veprimtari, qoftë përjashtimin nga këto detyrime tatimore. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 19, datë 03.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, parashikon në nenin 4<sup>16</sup>, kushtet për të përfituar nga skema e kompensimit. Bazuar në këtë parashikim ligjor, znj. V. H., për të përfituar nga skema e kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të kompensimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, kishte detyrimin për regjistrimin e aktivitetit të fermës pranë institucioneve tatimore. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se personi i lidhur me subjektin e ka ushtruar veprimtarinë e mbarështimit të lopëve pa qenë e regjistruar për këtë aktivitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (në vijim QKB) dhe në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve (në vijim DRT). DRT Fier<sup>17</sup> ka konfirmuar se znj. V. H. është e regjistruar si person fizik me NIPT {\*\*\*}, datë 14.10.2013, me objekt “Aktivitete të drejtësisë”, ndërsa QKB<sup>18</sup> konfirmon aktivitet tregtar në emër të V. H., regjistruar si person fizik me NIPT {\*\*\*}, duke i bashkëlidhur ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e personit fizik V. H., regjistruar më datë 14.10.2013, aktivitet “Avokate”, me vend ushtrimi të aktivitetit në Lushnje. Bazuar në këtë dokumentacion, rezulton se aktiviteti i mbarështimit të lopëve është kryer pa u regjistruar dhe deklaruar si i tillë në organet tatimore dhe ato të biznesit, duke lënë për rrjedhojë të paprovuar përjashtimin nga tatimi të të ardhurave të realizuara nga kjo veprimtari dhe nga shitja

<sup>15</sup> *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2019 (JR), datë 28.02.2019, paragrafi 21.12; nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 25.4; nr. 35, datë 23.11.2021, paragrafi 18.6.*

<sup>16</sup> *Neni 4, “Kushtet për të përfituar nga skema e kompensimit”, parashikon: “1. Fermeri përfiton të drejtën e kompensimit për sa kohë qarkullimi vjetor i tyre, bazuar në shitjet e kryera për produktet bujqësore kundrejt personave të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit, sipas vlerës totale të furnizimit të shënuar në faturë, nuk tejkalon kufirin minimal të përcaktuar të regjistrimit për TVSH-në. 2. Fermerët që i nënshtrohen këtij regjimi, janë përfitues të skemës së kompensimit nëse furnizojnë mallra me prejardhje nga puna e tyre e kryer për aktivitetet prodhuese bujqësore të përcaktuara sipas këtij udhëzimi. 3. Fermerët që janë objekt i skemës së kompensimit, duhet të pajisen me një numër identifikimi (NIPT), lëshuar nga drejtoria rajonale tatimore ku ushtron aktivitetin fermeri për të përfituar nga kjo skemë, pa iu nënshtuar detyrimit për deklarim”.*

<sup>17</sup> *Shih shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.01.2020, të DPT-së.*

<sup>18</sup> *Shih shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.1.2020, të QKB-së.*

e saj. Ky fakt sjell si pasojë moskonsiderimin si të ligjshme të të ardhurave të pretenduara prej kësaj veprimtarie në kuptim të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit.

91. Lidhur me pretendimin e ankuesit se ai dhe bashkëjetuesja e tij nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit, pasi kontrata e qirasë për kullotat nr. {\*\*\*}, datë 12.08.2013, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Sarandë dhe znj. H., ishte lidhur përpara fillimit të bashkëjetesës, trupi gjykues konstaton se kontrata është lidhur përpara datës 03.06.2014, të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2014, datë 24.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes së Komisionit, trupi gjykues vëren se kontrata e qirasë ka vijuar edhe pas datës 03.06.2014. Bashkëjetuesja e subjektit nuk kishte asnjë pengesë ligjore që, me hyrjen në fuqi të ligjit, të merrte menjëherë masa për zgjidhjen e kontratës, ashtu siç veproi në muajin gusht 2016. Kontrata e qirasë e sipërreferuar, në kreun “Zgjidhja e kontratës”, pika 1, përcakton: [...] *kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit, si dhe me marrëveshje të palëve [...]*. Nga ky përshkrim, rezulton se palët, me marrëveshje mes tyre, mund ta zgjidhnin kontratën edhe përpara përfundimit të afatit. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, nuk rezulton që znj. H. t’i ketë bërë ndonjë kërkesë palës qiradhënëse për zgjidhjen përpara afatit të kësaj kontrate dhe kjo kërkesë t’i jetë refuzuar. Bashkëjetuesja e subjektit, për rreth dy vite pas hyrjes në fuqi të ligjit, ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë në kushtet e konfliktit të interesit. Komisioni nuk rezulton të ketë bërë ndonjë kualifikim ligjor të kësaj situate faktike.
92. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se bashkëjetuesja e tij e ka krijuar aktivitetin e mbarështimit të lopëve me të ardhura financiare të ligjshme që kanë si burim dhuratat e prindërve të saj, të cilat kishin si burim përfitimin e dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit politikë, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur Komisioni, në arsyetimin e vendimit objekt kontrolli, ka pranuar se ky aktivitet është krijuar në vitin 2012, para fillimit të bashkëjetesës faktike në vitin 2014, konkluzioni në pikën 3.13 (faqe 24) të vendimit se personi i lidhur i subjektit nuk justifikon krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme, nuk mund të ketë pasojë në vlerësimin e kriterit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit.
93. Bazuar në sa më sipër, për këtë shkak të ankimit, trupi gjykues mbërrin në këto përfundime: (i) Subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara si të realizuara nga aktiviteti i mbarështimit të lopëve, në kuptim të nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, të cilat përkufizojnë si të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. (ii) Prej datës 03.06.2014, të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2014, deri në datën 22.8.2016, kjo veprimtari është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.
94. *Në lidhje me gjendjen cash jashtë sistemit bankar të bashkëjetueses V. H. në shumën prej 1.200.000 lekësh*, subjekti i rivlerësimit e kundërshton si të padrejtë vlerësimin e Komisionit se: *trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi, nuk mundi të krijojë ndonjë lidhje dhe, për pasojë, bindjen se shumat cash të deklaruara nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit janë me burim nga dëmshpërblimi i prindërve, përfituar në vitet 2010, 2011 dhe 2013 dhe, për pasojë, vlerëson se ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes cash të deklaruar në deklaratën “vetting”.*

95. Ky vlerësim i Komisionit u bazua në konstatimet se: (i) nuk provohet në ndonjë mënyrë dhënia e shumave nga babai i bashkëjetueses V. H., pas tërheqjes nga llogaria bankare; (ii) bashkëjetuesja, në deklaratimet e saj (DIPP-në e vitit 2014 dhe në deklaratën *vetting*), nuk mban të njëjtin qëndrim në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes *cash*, duke e ndryshuar atë në deklaratën *vetting*, çka nuk provon se çfarë ka ndodhur realisht deri në vitin 2014.
96. Pasuria gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, është deklaruar në deklaratën *vetting* nga personi i lidhur (bashkëjetuesja e subjektit) në shumën 1.200.000 lekë. Nuk rezulton që personi i lidhur të ketë deklaruar burimin e kësaj pasurie. Konstatohet se gabimisht kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë të personit të lidhur sipas Shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën ku kërkohet “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, në të cilën duhej të deklarohesh kjo gjendje *cash*, por është deklaruar në pjesën ku kërkohet “Përshkrimi i të ardhurave”, në të cilën personi i lidhur ka deklaruar të gjitha të ardhurat e saj nga viti 1996 e në vijim. Konstatohet se gjendja *cash* është deklaruar qartazi e palidhur me deklarin vijues: “të ardhura të krijuara nga dhurata të prindërve të mi, në shumën rreth 2.460.000 lekë, në vitet 2010, 2011 dhe 2013. Burimi i krijimit është dhuratë nga prindërit që i kanë përfutuar këto lekë, nga dëmshpërblimi për ish-të përndjekurit politikë”.
97. Në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur, në deklarin e saj të parë si bashkëjetuese e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar në pjesën e deklaratës “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”: *Kam kursyer në total, gjatë gjithë jetës sime nga puna para martesë, gjatë martesë, si e ve dhe në bashkëjetesë, si dhe nga aktiviteti im ekonomik (mbarështim lopësh) rreth 1.400.000 lekë, të cilat i kam një pjesë cash dhe në bankë. Pjesa takuese 100%.*
98. Në DIPP-në e vitit 2015, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar: *Kam fituar 1.400.000 lekë nga puna ime si avokate dhe ferma e lopëve. Me kursimet e vitit 2014 që i kam pasur një pjesë gjendje “cash” dhe një pjesë të vogël në Raiffeisen Bank, në total rreth 1.400.000 lekë, kam përballuar shpenzimet për arsimim fëmijësh dhe kam kontribuar në familje për ushqim, veshmbathje, pagesa energjie elektrike, uji, autovetura, pushime etj. Të ardhurat e fituara gjatë vitit 2015, afërsisht 1.400.000 lekë, i disponoj në gjendje “cash” dhe rreth 60.000 lekë i kam në llogarinë bankare te Raiffeisen Bank. Pjesa takuese 100%.*
99. Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur ka deklaruar: *Pakësuar gjendja e lekëve “cash” nga 1.400.000 lekë në 1.200.000 lekë. Pakësuar 200.000 lekë. Pjesa takuese 100%.* Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i personit të lidhur në deklaratën *vetting*, për gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar në shumën 1.200.000 lekë, duhet parë i lidhur me deklarin në DIPP-në e vitit 2016, ku rezulton si pakësim i gjendjes *cash* të vitit 2015.
100. Komisioni, për shkak të kuptimit të gabuar të deklarimeve të personit të lidhur në deklaratën *vetting* lidhur me burimin e krijimit të gjendjes *cash*, duke e konsideruar atë të lidhur me deklarin e të ardhurave të krijuara nga dhurata të prindërve në vitet 2010, 2011 dhe 2013, analizimin e kësaj pasurie rezulton ta ketë bërë vetëm në kuadër të provueshmërisë së përfitimit të dhuratave nga personi i lidhur, si dhe duke konstatuar ndryshimin midis deklarin që ajo ka bërë në DIPP-në e vitit 2014, në të cilën ajo për gjendjen *cash* nuk i referon si burim të ardhurat e dhuruara nga dëmshpërblimi i prindërve të saj, me deklarin e bërë në deklaratën *vetting* lidhur me gjendjen *cash*.

101. Bazuar në këtë analizë, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk mundi të krijojë bindjen se shuma *cash* e deklaruar në deklaratën *vetting* ishte krijuar nga dëmshpërblimi i prindërve të personit të lidhur, përfituar në vitet 2010, 2011 dhe 2013 dhe, për rrjedhojë, vlerësoi përfundimisht se bashkëjetuesja ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*.
102. Komisioni, në arsyetimin e vendimit, nuk ka bërë një analizë financiare lidhur me ecurinë e gjendjes së *cash*-it të deklaruar nga personi i lidhur në DIPP-të e viteve 2014, 2015, 2016 dhe në deklaratën *vetting*, të palidhur me dhuratat e prindërve të personit të lidhur, duke kontrolluar mundësinë reale të saj dhe të subjektit të rivlerësimit për ta krijuar këtë pasuri me burime të tjera, sipas deklarimeve të bëra në vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhe sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e dhëna për pyetësorin e Komisionit të datës 22.01.2021, në të cilat ka shpjeguar se: *shuma në vlerën 2.460.000 lekë, si dhuratë e prindërve, nga ana e bashkëjetueses sime është përdorur ndër vite dhe nuk ka qenë gjendje “cash” në vitin 2016. [...] Në deklaratën “vetting”, bashkëjetuesja ime ka shënuar të gjitha pasuritë e krijuara ndër vite, ku ka përshkruar edhe këtë shumë që e ka marrë përkatësisht në vitet 2010, 2011 dhe 2013, por nuk ka shkruar asgjëkundi që kjo shumë është gjendje “cash” në vitet 2015, 2016 apo 2017. Unë nuk kam pasur dijeni për këtë shumë sepse i është dhënë asaj dhe ajo e kishte përdorur para se unë të filloja bashkëjetesën. Deklarimin e parë, bashkëjetuesja e ka bërë më 20.03.2015 dhe nuk i ka pasur gjendje këto lekë, por i kishte konsumuar ndër vite [...].* Në kushtet e mungesës së kësaj analize, trupi gjykues, për një qëndrim garantist, vlerëson se konkluzioni i Komisionit për mungesën e burimeve financiare të ligjshme lidhur me këtë pasuri, nuk bazohet në një konstatim të plotë të situatës faktike dhe, si rrjedhojë, nuk mund të sjellë pasoja negative për subjektin e rivlerësimit.
103. Në lidhje me pasurinë *apartament banimi, ndodhur në kompleksin “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, pallatet e {\*\*\*}, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me këtë pasuri. Ai nuk mundi të provojë mundësitë financiare me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues krijoi bindjen se nëpërmjet veprimeve të njëpasnjëshme lidhur me blerjen e kësaj pasurie, ka pasur përpjekje për fshehjen e së vërtetës lidhur me këtë pasuri, duke e konsideruar pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.*
104. Ky vlerësim i Komisionit është bazuar në konstatimet se: (i) subjekti nuk ka deklaruar apartamentin në përdorim në emër të vëllait R. H., në rubrikën përkatëse të deklaratës *vetting*, por e ka deklaruar si adresë banimi; (ii) prokura e posaçme, e nënshkruar në Lushnjë, si dhe kontrata e porosisë, e nënshkruar në Tiranë, janë hartuar në të njëjtën datë, 24.12.2008, duke e bërë të duket e dyshimtë përse z. R. H. nuk arriti të firmoste vetë kontratën e porosisë, dhe përse u përfaqësua nga vëllai Artan Hazbi; (iii) duket e dyshimtë përse shtetasja N. B. arriti të blinte këtë pasuri në datën 19.12.2008 nga shtetasi R. A. dhe pas 5 ditësh ia shiti këtë pasuri vëllait të subjektit, z. R. H., përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit; (iv) nuk kuptohet qëllimi i blerjes së apartamentit nga shtetasja N. B., e cila e shiti 5 ditë më pas, ndërkohë që nuk kishte shlyer ende detyrimin ndaj shtetasit R. A.; (v) gjatë hetimit, subjekti deklaroi se ka filluar të jetojë në këtë apartament gjatë vitit 2014, ndërsa e deklaroi si adresë banimi që në DIPP-në e vitit 2010; (vi) nuk kuptohet qëllimi i blerjes së apartamentit nga vëllai i subjektit, z. R. H., në vitin 2008, kur prej asaj kohe dhe në vazhdim, aty jeton subjekti i rivlerësimit pa asnjë kompensim financiar ndaj tij, ndërkohë që vëllai dhe familja jetojnë mes Greqisë dhe

Konispolit; (vii) nuk arrihet të provohet aftësia paguese e vëllait të subjektit, z. R. H.; (viii) nuk arrihet të provohet se shuma prej 54.000 eurosh, është dhënë nga vëllai R. H. te subjekti Artan Hazbi për pagesën e apartamentit; (ix) shuma e blerjes së apartamentit prej 54.000 eurosh, deklarohet si e shlyer *cash*, në një vlerë të plotë, e gjitha në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë, ndaj shtetasës N. B., ndërkohë që kjo e fundit ka pasur detyrime të palikuiduara ndaj shtetasit R. A. për këtë pasuri të blerë 5 ditë më parë.

105. Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

- i. Kjo pasuri nuk është pasuri e subjektit të rivlerësimit, por është blerë nga vëllai i tij R. H., me të ardhurat e veta, me qëllim që t'u siguronte fëmijëve të tij, një mundësi banimi në pronën e vet, gjatë kohës së studimeve apo edhe më pas, nëse ndonjë nga fëmijët do të vendoste të qëndronte në Tiranë.
- ii. Vëllai i tij ka pasur aftësi paguese dhe të ardhurat e tij janë të ligjshme e me detyrime tatimore të paguara në shtetin grek.
- iii. Veprimet për blerjen e këtij apartamenti, janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, në emër dhe për llogari të vëllait të tij R. H., i cili kishte vendosur të blinte apartamentin, por për shkak të kohës së limituar dhe impenjimeve të punës në emigrim, e kishte të pamundur të kryente personalisht procedurat e lidhjes së kontratës për këtë pasuri, duke autorizuar me prokurë të posaçme subjektin e rivlerësimit për kryerjen e tyre.
- iv. Arsyeja e banimit të subjektit në këtë apartament, është ndjekja e procedurave të regjistrimit të pronës, për shkak të problemeve ndërmjet shitëses N. B. dhe shitësit të mëparshëm R. A.
- v. Përdorimi i këtij apartamenti është pa kundërshtim, pasi edhe subjekti i ka lënë të vëllait R. H. pa kundërshtim, banesën e tij në Konispol.
- vi. Deklarimin e përdorimit të kësaj banese, subjekti e ka bërë në deklarin periodik vjetor, në kohën që efektivisht ka banuar në të.

106. Nga aktet e fashikullit të çështjes, rezulton se pasuria “apartament” në Tiranë, me adresë kompleksi “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, pallatet e {\*\*\*}, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* si një pasuri në përdorim, megjithëse e përdorte atë në mënyrë të vazhdueshme, por e ka deklaruar vetëm si adresë banimi: *Kompleksi “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, {\*\*\*}, B. {\*\*\*}/\*\*\*, Tiranë (shtëpia e vëllait tim R. H., e peregjistruar, në të cilën jetoj pa qira)*. Për herë të parë ky apartament është deklaruar nga subjekti si adresë tjetër banimi në DIPP-në e vitit 2010.

107. Referuar dokumentacionit të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

107.1 Në datën 19.12.2008, është lidhur një kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., ndërmjet shitësit R. A. dhe blerëses N. B. Objekt i kësaj kontrate janë tri apartamente të ndodhura në objektin “{\*\*\*}, Tiranë”. Përmes kësaj kontrate, palët kanë përcaktuar edhe kushtet për likuidimin e çmimit brenda 5 muajve nga data e lidhjes së kontratës. Në kontratë parashikohet e drejta e N. B. për shitjen e këtyre apartamenteve, vetëm pas dhënies së pëlqimit nga ana e shitësit R. A.

107.2 Në datën 24.12.2008, njëri nga këto 3 apartamente i është shitur nga N. B., vëllait të subjektit R. H., i cili rezulton të jetë përfaqësuar në kontratën e porosisë (Premtim shitje apartamenti) të lidhur për këtë qëllim, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2008, nga

subjekti i rivlerësimit Artan Hazbi. Palë e tretë në këtë kontratë ka qenë edhe R. A., në cilësinë e dhënësit të pëlqimit.

**107.3** Në të njëjtën datë me lidhjen e kontratës së mësipërme, R. H. është paraqitur pranë një zyre noteriale në qytetin e Lushnjës, ku ka lëshuar prokurën e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me të cilën ka autorizuar vëllain e tij Artan Hazbi të ketë të drejtën për t'u paraqitur pranë çdo zyre noteriale për të redaktuar një kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, kudo që ndodhet kjo pasuri e paluajtshme, ku unë, porositësi, jam në cilësinë e palës blerëse dhe përfaqësuesi im do të ketë të drejtën që me palën shitëse të përcaktoj çmimin e blerjes, të drejtën për të kryer pagesën e blerjes së pasurisë së paluajtshme, duke nënshkruar në emrin tim dhe në mungesën time [...].

**107.4** Me deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., datë 27.12.2008, shitësja N. B. ka deklaruar se: *Deklaroj se në datën 24.12.2008, zoti R. H. H., më ka likuiduar të gjithë shumën për blerjen e apartamentit 2+1, me sipërfaqe të përgjithshme 94,15 m<sup>2</sup>, kati i pestë, që ndodhet në kompleksin e banesave {\*\*\*}, Tiranë [...].*

**107.5** Subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij R. H. kanë hartuar në datën 20.10.2016, deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol. Në këtë akt noterial, deklaruesi R. H. ka deklaruar: *kam prenotuar për blerje, nëpërmjet kontratës së porosisë me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2008, një apartament banimi me nr. B{\*\*\*}/\*\*\*, me sipërfaqe të përgjithshme 94,15 metra katrorë, kati i pestë, që ndodhet në kompleksin “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Tiranë. Objekti është i përfunduar, por i paregjistruar në ZRPP Tiranë. Në këtë akt, subjekti Artan Hazbi ka deklaruar: kam në pronësi, një banesë vetjake dhe truall, me nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, sipas certifikatës për vërtetim pronësie me nr. {\*\*\*}, datë 09.11.2011. Banesa ndodhet në Konispol, Sarandë, dhe është pasuri e trashëguar nga prindërit e mi, të ndjerët H. dhe D. H. Në vijim, deklaruesit kanë pohuar se: [...] i kemi lënë njëri-tjetrit në gëzim dhe përdorim, pa kundërshpërblim, pra pa qira dhe pa pagesa reciproke, pasuritë e sipërcituara që prej datës së lidhjes së kontratës të prenotimit për blerje të apartamentit që R. H. ka bërë në Tiranë dhe që nga viti 2010, për banesën dhe truallin në Konispol [...].*

**107.6** Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar në Komision dy deklarata (shkresa të thjeshta), të nënshkruara në datën 07.04.2021, përkatësisht nga nipi E. H. dhe nga kunata A. H. Gjithashtu konstatohet të ketë depozituar edhe kopje të diplomës nr. {\*\*\*}, datë 20.03.2015, në emër të E. H., lëshuar nga Shkolla e Lartë Universitare “Justicia”. Deklaruesi E. H. ka deklaruar se: *Në vitin 2008, ne si familje, me të ardhurat e babait si emigrant në Greqi, të nënës si punëtoreshë bujqësie, kursimeve nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale, kemi blerë një apartament 2+1 të kompleksi {\*\*\*}, {\*\*\*}, blloku {\*\*\*}, apartamenti {\*\*\*}, Tiranë. Qëllimi i blerjes ka qenë për t'u përdorur nga unë dhe motra ime kur të studionim në Tiranë. Në këtë apartament, nga viti 2009-2011, kanë banuar të afërmit e mi. Më pas, deri në vitin 2014, është përdorur nga ana ime, kur kam qenë student në Universitetin Justicia, ku kam studiuar për drejtësi. Më pas, në këtë apartament, ka banuar dhe banon aktualisht xhaxhai im Artan Hazbi. Ai rri pa qira sepse na ka lënë në përdorim banesën e tij në Konispol, truallin dhe pemët. Edhe ai na i ka lënë në përdorim pa shpërblim. Të njëjtën përmbajtje ka edhe deklarata e kumatës A. H.*

**108.** Në analizë të fakteve si më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se:

**108.1** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjatë procesit në Komision, se ai ka filluar të banojë në apartamentin objekt kontrolli vetëm në vitin 2014, u vlerësua nga trupi gjykues i pabesueshëm. Këtë konkluzion, trupi gjykues e bazon në radhë të parë në përmbajtjen e deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.10.2016, të lëshuar nga subjekti dhe vëllai i tij, sipas së cilës përpara noterit publik, me vullnetin e tyre të lirë kanë deklaruar se subjekti i rivlerësimit ka filluar ta përdorë apartamentin e porositur nga i vëllai që në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë më datë 24.12.2008. Vetëdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2010, i adresës së banimit në *Kompleksin “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Blloku {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, Tiranë* konfirmon pohimin e mësipërm të bërë përpara noterit, se subjekti i rivlerësimit ka banuar në këtë apartament para vitit 2014. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit se në vitin 2010, në këtë apartament ka filluar të banojë nip i tij E. H., vjen në kontradiksion të hapur me deklaratën e datës 07.04.2021 të vetë nipit E. H. dhe nënës së tij A. H., të cilët kanë deklaruar se në vitet 2009-2010, në këtë apartament kanë banuar të afërm të tyre. Ky kontradiksion bën të pabesueshëm pretendimin e këtyre deklaruësve se subjekti i rivlerësimit ka filluar të banojë në këtë adresë në vitin 2014. Gjithashtu, edhe pretendimi tjetër se subjekti i rivlerësimit ka nisur të banojë në këtë apartament nga mesi i vitit 2014 e në vazhdim, për shkak të problemeve të lindura ndërmjet pronarëve të mëparshëm N. B. dhe R. A., vjen në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga vetë subjekti i rivlerësimit<sup>19</sup>, i cili konfirmon se problematikat kanë lindur gjatë vitit 2010 dhe jo 2014, duke bërë edhe më të besueshëm faktin se subjekti i rivlerësimit jetonte në vitin 2010 në këtë apartament.

**108.2** Në kontekstin e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në prapësimet kundër rezultateve të hetimit<sup>20</sup>, të konfirmuara edhe në ankim, sipas të cilave pretendohet se vëllai i subjektit ishte prezent në Tiranë në datën 24.12.2008, kur është lidhur kontrata e porosisë, ndërkohë që kishte lëshuar një prokurë të posaçme duke ngarkuar si përfaqësues për nënshkrimin e saj subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të pabesueshëm pretendimin për pamundësinë e nënshkrimit personalisht të kontratës, pasi i duhet të kthehej në Konispol brenda ditës për shkak të impenjimeve të tjera. Pretendimi se i vëllai nuk mund ta ndiqte personalisht procedurën e nënshkrimit të kontratës, do të ishte i pranueshëm nëse kontrata do të lidhej në ndonjë ditë tjetër, të mëvonshme, por sa kohë lidhja e kontratës u krye brenda ditës, ky veprim nuk mund të mbështetet nga një interpretim logjik i ngjarjeve.

**108.3** E palogjikshme duket edhe dinamika e veprimeve të shpjeguara prej subjektit se vëllai i tij po likuidonte shitësen N. B., ndërkohë që subjekti po shikonte apartamentin objekt kontrate, në kushtet që pala e interesuar për të parë nëse pasuria e paluajtshme për të cilën po kryhej investimi në blerje ishte apo jo brenda pritshmërive të blerësit dhe justifikonte shumën e investuar do të ishte vetë blerësi dhe jo përfaqësuesi me prokurë.

---

<sup>19</sup> *Shih shkresën, datë 01.12.2010, të z. R. A. drejtuar z. R. H., me lëndë “Njoftim për zgjidhjen e kontratës së porosisë, rikthimin e palëve në gjendjen fillestare, duke kërkuar lirim dhe dorëzimin e apartamentit të banimit”.*

<sup>20</sup> *Në prapësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar: “[...] Ai erdhi nga Saranda me makinë dhe do të kthehej përsëri brenda së njëjtës ditë. Më takoi mua në Lushnjë. Kishte vendosur ta blinte apartamentin prandaj bëri prokurën në Lushnjë. Erdhi në Tiranë së bashku me mua. Ai i dha lekët (euro) pronares N. B. në kohën që unë po shikoja apartamentin. Dhe u rikthye po atë natë në Konispol. Duke qenë se ai i dha lekët dhe mua më kishte bërë prokurë, unë qëndrova për të bërë dokumentet [...]”.*

**108.4** Trupi gjykues vëren gjithashtu se përmbajtja e prokurës dhe tagrat e dhëna nga z. R. H. të vëllait (subjektit të rivlerësimit) vlerësuar në raport me datën e lëshimit të saj, e cila përkon me datën e nënshkrimit të vetë kontratës së porosisë, tregojnë se qëllimi i vërtetë i hartimit dhe përdorimit të saj nuk ka qenë ai i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, se apartamenti do të blihej nga i vëllai. Këtë qëndrim, trupi gjykues e bazon, së pari, në faktin që në kontratën e porosisë nuk ka asnjë referim të prokurës së posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2008, pasi në pjesën hyrëse të kontratës nuk referohet që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë përfaqësues me prokurë i blerësit [përveç pjesës së nënshkrimeve të kontratës ku blerësi tregohet se është përfaqësuar me prokurë (pa specifikim kredencialesh) nga subjekti i rivlerësimit Artan Hazbi]. Së dyti, trupi gjykues konstaton se tagrat e dhëna subjektit të rivlerësimit nga i vëllai, në përfaqësimin e tij në këtë marrëdhënie juridiko-civile, nuk përputhen me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi veprimet e pretenduara si të kryera prej tij dhe të vëllait në ditën e lidhjes së kësaj kontrate. Më konkretisht, trupi gjykues vëren se ndërkohë që sipas prokurës së posaçme të lëshuar në datën 24.12.2008, subjekti i rivlerësimit ishte pajisur me tagrat: (i) për të redaktuar një kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, kudo që të ndodhej kjo pasuri e paluajtshme, ndërkohë që, sipas subjektit në ankim, i vëllai e kishte të identifikuar këtë apartament banimi nga njerëzit e bashkëshortes së tij; (ii) të kishte të drejtën që me palën shitëse të përcaktonte çmimin e blerjes dhe të kryente pagesën e tij, ndërkohë që, sipas shpjegimeve të vetë subjektit, në të njëjtën datë me këtë prokurë i vëllai ishte i përgatitur (dispononte) dhe pagoi personalisht çmimin e blerjes në shumën prej 54.000 eurosh, shitëses N. B., në Tiranë; dhe (iii) të nënshkruante në emrin e të vëllait dhe në mungesë të tij, ndërkohë që, sipas pretendimit të subjektit, po atë ditë ata udhëtuan të dy së bashku nga qyteti i Lushnjës drejt Tiranës.

**108.5** Në lidhje me vlerësimin e mundësisë financiare të vëllait të subjektit për blerjen e kësaj pasurie me burime të ligjshme, trupi gjykues analizon se:

**108.6** Sipas kontratës së porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2008 (me palë blerëse vëllain e subjektit dhe palë shitëse znj. N. B.), çmimi i shitjes së apartamentit në Tiranë është 54.000 euro, i cili do t'i paguhej shitëses me një këst të vetëm, në formën “cash në dorë”, në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Sipas deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 27.12.2008, të znj. N. B., kjo e fundit deklaroi se blerësi, z. R. H., ka shlyer të gjithë çmimin prej 54.000 eurosh në datën 24.12.2008.

**108.7** Në prapësimet kundër rezultateve të hetimit (por edhe në ankim), subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, duke shpjeguar se vëllai i tij R. H. ka punuar në Greqi prej vitit 1990, fillimisht si emigrant i paligjshëm, për të ikur sërish në vitin 1993, kësaj radhe me vizë të rregullt. Subjekti pretendon se nga viti 1998 e deri në vitin 2020, vëllai i tij ka pasur leje qëndrimi dhe pune në shtetin grek, ku ka kryer punë të ndryshme si hidraulik, elektrikist, murator, punëtor në bujqësi, në blegtori, në peshkim etj., në shumë raste ka punuar edhe në dy punë në të njëjtën ditë. Sipas subjektit, vëllai i tij nuk ka pasur shpenzime fjetjeje dhe ushqimi pasi ka fjetur pa qira në banesa të dedikuara për punëtorët dhe ushqimi është mbuluar nga pronarët. Bashkëshortja e tij ka punuar në punë bujqësie në Konispol. Me kursimet e të ardhurave të fituara nga puna e tij dhe ekonomia familjare, ka siguruar të ardhurat për blerjen e këtij apartamenti. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, vetëm nga puna te një pronar grek i quajtur G. P., për periudhën 1998-2010, ai ka përfituar rreth 91.000 euro ose ekuivalentin e tyre. Subjekti pretendon gjithashtu se shpjegimet

e tij vërtetohen me kopje të pasaportës shqiptare për jashtë shtetit, me viza greke e leje qëndrimi greke, me librin e shëndetit, me deklaratën e shtetasit G. P. Trupi gjykues konstaton se në mbështetje të sa më sipër, subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve të tij, ka depozituar dokumentet si më poshtë:

(i) Librezë personale shëndetësore<sup>21</sup> e të siguarit, lëshuar nga Organi i Sigurimeve Bujqësore në shtetin grek, e vlefshme për periudhën 30.10.2000 deri më 31.12.2020.

(ii) Fotokopje të faqes së pasaportave të vëllait të tij, z. R. H., ku është pajisur me vizë greke për periudhat: 21.02.1994 - 21.02.1995 (me të drejtë qëndrimi 3 muaj); 18.04.1995 - 18.04.1996 (me të drejtë qëndrimi 3 muaj); 06.03.1998 - 06.07.1998 (kohëzgjatja e qëndrimit 100 ditë); 12.11.1998 - 12.03.1999 (kohëzgjatja e qëndrimit 90 ditë).

(iii) Leje qëndrimi me të drejtë aksesimi në tregun e punës, për periudhën 28.11.2004 - 23.07.2020.

(iv) Deklaratë nga G. P., e lëshuar në datën 05.03.2020, në të cilën deklarohet se R. H. ka qenë i punësuar në aktivitete bujqësore në Komunën Sagiada të Bashkisë Filiates në vitet 1998-2010 me pagë 7.000 euro në vit, ose në total 91.000 euro, i regjistruar me nr. tatimor {\*\*\*} dhe nr. regjistri shëndetësor {\*\*\*}.

(v) Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 6.5.2021 të DRSSH Sarandë, sipas të cilit znj. A. H. është e siguar si fermere për periudhën 1.10.1993 – 31.12.2009.

109. Në analizë të dokumentacionit justifikues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të nevojës për të provuar krijimin e të ardhurave nga i vëllai nga puna e tij në emigracion, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues, mundësinë financiare me të ardhura të ligjshme, të vëllait të tij, z. R. H., për blerjen e apartamentit të banimit në Tiranë gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se nga aktet e dorëzuara në cilësinë e dokumenteve justifikuese nuk arrihet të provohet masa e të ardhurave të pretenduara nga emigracioni, për të vlerësuar në vijim edhe plotësimin e kriterëve të tjera të përcaktuara sipas standardit kushtetues të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave në kontekst të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit në lidhje me këtë çështje. Në kontekst të sa më sipër, trupi gjykues vëren se deklarata e ish-punëdhënësit grek konfirmon vetëm faktin e punësimit prej tij të z. R. H. dhe regjistrimin me nr. tatimor {\*\*\*}, por nuk shoqërohet me të dhëna që vërtetojnë pagesat e përfituara si kundërshtpërblim dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore përkatëse. Për më tepër, ky dokument vlerësohet me rezervë nga trupi gjykues jo vetëm për faktin se nuk është një dokument i kohës, por më shumë edhe për faktin se ky dokument shprehet për pagesë në monedhën euro për periudhën 1998 – 2001, ndërkohë që në këtë kohë monedha zyrtare në shtetin grek ka qenë “dhrachmia”, dhe zëvendësimi i saj me monedhën euro është miratuar në datën 01 janar 2002<sup>22</sup>.

<sup>21</sup> Kopje e njëzuar me aktin notarial nr. {\*\*\*} rep., datë 22.12.2020.

<sup>22</sup> Shihni të dhënat e publikuara në faqen e Bankës Qendrore Evropiane dhe atë të Bankës së Shqipërisë: <https://www.ecb.europa.eu/euro/changeover/2002/html/index.en.html> ; [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Buletini\\_ekonomik\\_Vellimi\\_4\\_Nr\\_2\\_Monedha\\_EURO\\_eshte\\_te\\_pragu\\_1976\\_1\\_6397.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Buletini_ekonomik_Vellimi_4_Nr_2_Monedha_EURO_eshte_te_pragu_1976_1_6397.pdf).

110. Në të njëjtin konkluzion arriti trupi gjykues edhe sa u takon të ardhurave të pretenduara si të krijuara nga bashkëshortja e z. R. H. Konstatohet se shkresa e ISSh-së Sarandë, nr. {\*\*\*} prot., datë 06.05.2021, nuk përmban të dhëna lidhur me vlerën e të ardhurave të znj. A. H. si fermere, mbi të cilat ajo ka paguar kontribute. Libreza e kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor e kumatës së subjektit, znj. A. H., nuk vërteton ndonjë vlerë konkrete të ardhurash të realizuara prej saj, por vetëm pagesën e kontributeve. Gjithashtu, në fashikullin e Komisionit nuk është administruar asnjë dokument tjetër që mund të hedhë dritë mbi masën e të ardhurave që mund të ketë përfituar kunata e subjektit nga kjo veprimtari.
111. Në përfundim të analizës së mësipërme, pasi konstatoi: (i) përdorimin e apartamentit objekt kontrolli nga subjekti i rivlerësimit, që nga data e lidhjes së kontratës së porosisë në vitin 2008 e në vijim; (ii) mungesën e burimeve të ligjshme financiare nga i ndjeri R. H. për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti; (iii) nënshkrimin nga subjekti i rivlerësimit të kontratës së porosisë si përfaqësues me prokurë, por pa referim të këtij akti përfaqësimi në kontratë; (iv) hartimin në ditën e lidhjes së kontratës së një prokure të posaçme, e cila nuk rezulton të ketë asnjë lidhje logjike dhe objektive me kontratën e porosisë së apartamentit dhe me faktet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e lidhjes së saj dhe pagimit të çmimit; si dhe (v) mungesën e interesit të z. R. H. për të parë konkretisht (këqyrur) apartamentin që po blinte edhe pse ndodhej në Tiranë në atë moment kohor kur apartamentin po e këqyrte subjekti i rivlerësimit – trupi gjykues gjeti të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet veprimeve të njëpasnjëshme lidhur me blerjen e kësaj pasurie, ka pasur përprjekje për fshehjen e së vërtetës për këtë pasuri, duke e konsideruar pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit*. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit, nga kontrolli i ushtruar lidhur me këtë pasuri, gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
112. Në lidhje me pasurinë truall me sipërfaqe 277 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën {\*\*\*} Sarandë, blerë shtetasit N. C. dhe shitur më pas shtetasit M. V., subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit se *subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe se nuk ka paguar detyrimet tatimore për buxhetin e shtetit lidhur me të ardhurat e realizuara nga transaksioni i kryer*.
113. Ky vlerësim i Komisionit është bërë bazuar në konstatimet se: (i) subjekti e ka shitur truallin e mësipërm, fill pas 3 ditësh nga dita e blerjes, 1,44 herë më shumë se çmimi i blerjes; (ii) subjekti nuk i ka deklaruar veprimet juridike të mësipërme në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në deklaratën *vetting*; (iii) nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurën e realizuar nga këto veprime juridike; (iv) duket e dyshimtë dhe e paqartë arsyeja e blerjes së truallit nga subjekti i rivlerësimit dhe shitja pas 3 ditësh, ndërkohë, që shitja mund të realizohej nga pronari i parë (N. Ç.); (v) duket se subjekti i rivlerësimit vepron si biznesmen dhe jo si prokuror.
114. Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se:
- i. Pasurinë e ka blerë në vitin 2002 me mendimin që të ndërtonte shtëpinë, por për shkak se nuk i kishte lekët për ndërtim dhe meqë iu dha rasti pas disa ditësh për ta shitur, vendosi ta shiste.
  - ii. Në DIPP-në e vitit 2004 nuk e ka deklaruar pasi në formular mungonte rubrika përkatëse, ndërsa në deklaratën *vetting*, e kishte harruar fare si transaksion.

iii. Tatimi mbi të ardhurat nga shitja duhet t'i jetë mbajtur nga ZVRPP Sarandë, pasi ai e ka shitur pasurinë si qytetar dhe jo si subjekt tregtar.

115. Nga aktet e fashikullit të Komisionit, rezulton se subjekti e ka blerë këtë pasuri në datën 05.11.2002 nga shitësi N. Ç. kundrejt shumës 277.000 lekë dhe, pas tri ditësh, më datë 08.11.2002, ia ka shitur shtetasit M. V. kundrejt shumës 400.000 lekë. Në datën 31.12.2003, subjekti nuk e ka pasur në pronësi këtë truall e, për rrjedhojë, nuk mund ta deklaronte në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003. Ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti nuk e ka deklaruar këtë të ardhur dhe as përdorimin e saj si burim për krijimin e ndonjë pasurie.

116. Konstatohet se Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim se si ka arritur në konkluzionin se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Ky konkluzion i Komisionit nuk rezulton as në rezultatet e hetimit administrativ që i janë përcjellë subjektit të rivlerësimit. Nga analiza e kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime nga të ardhura të ligjshme. Në këto kushte, kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën *vetting* shumën e përfituar nga shitja e këtij trualli si burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër, çështja e pagimit të tatimit mbi këtë shumë nuk ka asnjë pasojë ligjore për vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe zgjidhjen e çështjes.

117. Në lidhje me analizën financiare, për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit kundërshton metodologjinë e analizës së bërë nga Komisioni, e cila, sipas tij, e ka çuar në një rezultat të gabuar të balancës negative, për disa arsye:

- Për minimumin jetik, nuk është marrë në konsideratë fakti që subjekti ka pasur shtëpi në fshat, tokë, pemëtari, bagëti, shpendë shtëpiake, të cilat kanë mundësuar jo vetëm produkte ushqimore, por edhe të ardhura nga shitja e produkteve, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e shpenzimeve të jetesës në raport me ato të përlllogaritura nga Komisioni.
- Balanca negative për blerjen e banesës në vitin 1995, nga EKB Sarandë, është rrjedhojë e mospërfshirjes në këtë analizë të të ardhurave të krijuara nga pensionet e pleqërisë së prindërve.
- Balanca negative për mundësinë e blerjes në vitin 2007, të apartamentit të banimit në Sarandë, në vlerën 1.800.000 lekë, ka ardhur si pasojë e mospërfshirjes në analizën e këtij viti, të të ardhurave të krijuara nga: (i) shitja në vitin 2006 e autoveturës në vlerën 250.000 lekë, të ardhura të cilat i ka pasur gjendje në vitin 2007; (ii) të ardhurat nga pensioni i nënës në vlerën 100.000 lekë.
- Shuma 1.100.000 lekë, e tërhequr nga banka nga ana e subjektit në vitin 2012, të cilat i ka pasur gjendje “cash” edhe në vitin 2013, nuk është përfshirë në analizën financiare të vitit 2013, duke ndikuar në balancën negative prej 1.200.000 lekësh të këtij viti.
- Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur gabimisht në shumën 90.000 lekë në vit, ndërkohë që subjekti nuk i ka pasur realisht këto shpenzime, për shkak se ka fjetur në zyrë dhe në vitet 2005 – prill 2007, ka pasur në përdorim automjetin e prokurorisë, përfshirë karburantin, për shkak të ushtrimit të funksionit si drejtues prokurorie.
- Nuk janë llogaritur të ardhurat e krijuara nga shitja e ullinjve, por vetëm shpenzimet për shërbimet ndaj tyre.
- Nuk janë llogaritur kursimet e bashkëjetueses së tij, para, gjatë dhe pas martesës dhe ato të krijuara para fillimit të bashkëjetesës me subjektin.

- Nuk janë llogaritur të ardhurat në shumën 2.400.000 lekë, të dhuruara nga prindërit e bashkëjetueses, me burim krijimi dëmshpërblimin për ish-të përndjekurit politikë.
- Nuk janë llogaritur të ardhurat në shumën 510.000 lekë, përfituar nga punësimi i bashkëjetueses pranë subjektit “{\*\*\*}” ShPK.
- Nuk janë llogaritur të ardhurat e pensionit ushqimor për fëmijën e bashkëjetueses K. H., në shumën 700.000 lekë.
- Nuk janë llogaritur të ardhurat e krijuara nga shitja e qumështit dhe mishit në fermën e lopëve, në vitet 2014 dhe 2015, në shumën rreth 1.800.000 lekë.

118. Lidhur me këtë shkak të ankimit, trupi gjykues konstaton se për analizën financiare të kryer për periudhën 2003 - 2016, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbyste rezultatin e hetimit për mungesë burimesh financiare në vlerën negative prej (-) 5.724.914 lekësh, por vetëm ta zbuste atë, në vlerën prej (-) 5.547.482 lekësh, pas pranimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit (për periudhën 2003-2010), në vlerën 670.303 lekë.

119. Trupi gjykues, bazuar në aktet e fashikullit të Komisionit, analizoi dhe vlerësoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit si më poshtë.

Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, shpenzimet për jetesë që përlllogariten sipas të dhënave të INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme të të dhënave të njësisive familjare që përfshin edhe nivelin e varfërisë. Ato përdoren në rastet kur subjekti nuk paraqet prova për të provuar të kundërtën e këtyre të dhënave. Nga aktet e çështjes, rezultoi se subjekti nuk ka arritur të provojë ndonjë vlerë konkrete të shpenzimeve të jetesës të pretenduar ndër vite. Nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të Komisionit, rezultoi se shpenzimet për jetesë janë përlllogaritur në përputhje me metodologjinë e ILDKPKI-së, përveç vitit 2007<sup>23</sup>, të cilat i ka konsideruar më të ulëta, në favor të subjektit.

120. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga produktet bujqësore dhe blegtorale të përfituara gjatë viteve 1993-1998 dhe që lidhen me burimin e blerjes së apartamentit në Sarandë në vitin 1995, trupi gjykues vlerëson se ai nuk ka asnjë ndikim për çështjen, për arsye se, siç është analizuar më sipër në këtë vendim, në shkakun e ankimit që lidhet me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit u gjet me burime financiare të ligjshme për blerjen e saj.

121. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të vitit 2007 të shumës 250.000 lekë të përfituar nga shitja e automjetit të markës “Mercedes Benz” në vitin 2006, trupi gjykues e ka gjetur të drejtë vlerësimin e Komisionit për mospërfshirjen e tyre, bazuar në analizën e bërë më sipër për shkakun e ankimit që lidhet me apartamentin e banimit të blerë nga subjekti në qytetin e Sarandës në vitin 2007, për sa kohë kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti si kursim në DIPP-në e vitit 2006.

122. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka përfshirë në analizë të ardhurat nga pensionet e prindërve, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e nënës nga pensioni janë llogaritur në shumën 670.303 lekë. Kjo përlllogaritje rezulton të jetë e drejtë nga Komisioni pasi është

---

<sup>23</sup> Sipas shkresës së ILDKPKI-së, shpenzimet minimale për konsum për një familje me dy persona, llogariten në vlerën 471.936 lekë, ndërsa Komisioni i ka llogaritur në vlerën 273.240 lekë.

bërë në përputhje me informacionin e përcjellë nga ISSh-ja për periudhën 1994 - 2010. Sa u përket të ardhurave të pretenduara nga pensioni i babait deri në vitin 2000, trupi gjykues vlerëson se ato nuk kanë ndikim në analizën e burimeve të ligjshme lidhur me pasurinë apartament të blerë në vitin 1995 në Sarandë, pasi, siç është analizuar më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mundësi financiare, me të ardhura të ligjshme, për blerjen e tij.

123. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk është përfshirë si e ardhur shuma prej 1.100.000 lekësh, e tërhequr në vitin 2012 nga banka, të cilën ai “beson” se mund ta ketë pasur gjendje *cash* edhe në vitin 2013, duke dalë për rrjedhojë me balancë negative rreth 1.200.000 lekë në këtë vit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në datën 23.08.2012, ka tërhequr nga llogaria e tij në Bankën Credins shumën 1.100.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga në shumën 450.000 lekë, por nuk rezulton të ketë deklaruar si gjendje *cash*, shumën 1.100.000 lekë të tërhequr nga banka. Në këto kushte, vlerësohet se Komisioni me të drejtë nuk e ka pasqyruar atë në analizën financiare të vitit 2013.
124. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka përfshirë në mënyrë të padrejtë në analizën financiare shpenzimet e transportit në shumën përafërsisht 90.000 lekë në vit për periudhën 2006 – 2013, pasi ai ka fjetur në zyrë, ndërsa për periudhën 2005 – prill 2007 ka qenë drejtues i Prokurorisë dhe kishte në përdorim makinën dhe karburantin e vënë në dispozicion nga institucioni, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor masën e shpenzimeve të mbuluara të transportit dhe as ka referuar ndonjë akt ligjor të kohës, që parashikonte mbulimin e këtyre shpenzimeve nga buxheti i shtetit. Subjekti nuk ka deklaruar për këto vite vendqëndrim në qytetin e Lushnjës dhe gjatë hetimit administrativ në Komision ka deklaruar<sup>24</sup> se ka udhëtuar vajte-ardhje Lushnjë-Konispol. Për rrjedhojë, vlerësohet i drejtë qëndrimi i Komisionit për ngarkimin e shpenzimeve të transportit në analizën financiare të subjektit.
125. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga shitja e ullinjve për vaj, trupi gjykues e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit, bazuar në analizën e bërë më sipër në këtë vendim për shkakun e ankimit që lidhet me aktivitetin e kultivimit të ullinjve, pasi subjekti dështoi të provojë me dokumentacion ligjor masën e këtyre të ardhurave dhe përjashtimin nga detyrimet tatimore.
126. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të kursimeve të bashkëjetueses, të akumuluar para fillimit të bashkëjetesës, shumat e dhuruara asaj nga prindërit, me burim dëmshpërblimin për ish-të përndjekurit politikë, të ardhurat e saj nga punësimi në periudhën 04.06.2009 – 31.12.2010, pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues vlerësoi se këto pretendime kanë ndikim në analizën financiare të vitit 2014. Rezultoni se në analizën financiare bashkëlidhur rezultateve të hetimit administrativ, në vitin 2014, Komisioni ka pasqyruar pasuritë apartament banimi dhe automjet në pronësi të bashkëjetueses, aktivitetin e mbarështimit të lopëve dhe kursimet që ajo ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014. Komisioni, në këtë analizë, nuk e ka ngarkuar subjektin me shpenzim për krijimin e pasurisë automjet dhe aktivitetin e mbarështimit të lopëve, por e ka ngarkuar me

---

<sup>24</sup> Në përgjigje të pyetjes nr. 1 në pyetësorin e datës 27.01.2021.

shpenzim për krijimin e pasurisë apartament në Lushnjë, të blerë me kontratën e shitblerjes të datës 11.11.2013 dhe kursimet e deklaruara si të krijuara para bashkëjetesës. Në vlerësimin e trupit gjykues, në analizën financiare të këtij viti, nuk duhet të konsiderohet si shpenzim vlera e blerjes së apartamentit nga bashkëjetuesja, pasi Komisioni në pikën 1.10 (faqe 21) të vendimit objekt kontrolli, ka vlerësuar të mos përfshijë këtë pasuri të personit të lidhur, në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se në kushtet ku Komisioni nuk ka bërë një analizë nëse kursimet e deklaruara nga bashkëjetuesja në DIPP-2014, si kursime të bëra para bashkëjetesës, ishin krijuar ose jo nga burime të ligjshme, pasqyrimi i këtyre kursimeve si shpenzim i bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në vitin 2014, është i pabazuar. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi që të korrigjojë analizën e Komisionit për vitin 2014, duke mos përfshirë pasurinë apartament në Lushnjë dhe kursimet e bashkëjetueses përpara vitit 2014. Nga ky korrigjim, rezultati financiar negativ për vitin 2014, prej (-) 2.711.003 lekësh bëhet një rezultat pozitiv prej 135.192 lekësh.

127. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mospërfshirjen nga Komisioni në analizën financiare, të të ardhurave të përfituara nga bashkëjetuesja e tij në vlerën 700.000 lekë për të gjithë periudhën, si pension familjar për djalin, K. H., trupi gjykues konstaton se nga vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2016, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, rezulton se personi i lidhur, znj. V. H., ka përfituar pension familjar për fëmijën K. H., në vitin 2014 shumën 62.816 lekë, në vitin 2015 shumën 63.747 lekë dhe në vitin 2016 shumën 53.709 lekë, në total është përfituar shuma prej 180.272 lekësh. Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj analizës financiare të Komisionit, nuk rezulton që këto të ardhura të jenë pasqyruar në një zë të veçantë, por rezulton se të ardhurat e bashkëjetueses pas fillimit të bashkëjetesës, janë pasqyruar më të larta se ato të vërtetuara nga DRT<sup>25</sup> Fier, që nënkupton se këto të ardhura nga pensioni familjar janë përfshirë në analizë financiare.
128. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni duhej të kishte përfshirë në analizën financiare edhe të ardhurat përafërsisht në shumën 1.800.000 lekë, të përfituara nga shitja e qumështit dhe mishit në fermën e lopëve në vitet 2014 dhe 2015, trupi gjykues e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit, bazuar në analizën që i ka bërë më sipër në këtë vendim shkakut të ankimit që lidhet aktivitetin e mbarështimit të lopëve të personit të lidhur, për shkak të mosjustifikimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave në kuptim të pikës 3 të nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës.
129. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se për periudhën e rivlerësimit 2003 - 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, edhe pas korrektimit të analizës financiare, rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera në vitet 2005, 2007, 2011, 2012 dhe 2016 në shumën (-) 2.836.018 lekë. Për rrjedhojë, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
130. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit

---

<sup>25</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 13.01.2020.

Artan Hazbi, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë dhe, si rrjedhojë, ai nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri.

131. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 375, datë 26.04.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 375, datë 26.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 19.11.2024, në Tiranë.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**  
*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**  
*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**  
*nënshkrimi*

#### **RELATOR**

**Sokol ÇOMO**  
*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**  
*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me vendimin nr. 59, datë 19.11.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 375, datë 26.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi, por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues sa i përket arsytimit dhe konkluzionit lidhur me zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
2. Si gjyqtare në këtë mendim paralel, çmoj se konkluzionin e Komisionit sipas të cilit: *nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016*, edhe shumica e trupit gjykues duhet ta kishte analizuar çështjen edhe në këndvështrim të kësaj dispozite ligjore.
3. Më konkretisht, për pasuritë e trajtuara në kuadër të procesit të rivlerësimit: (i) pasurinë e llojit “*truall*” me sipërfaqe 306 m<sup>2</sup> për ndërtim banese, përfituar nga subjekti i rivlerësimit në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 15.03.1996, të Këshillit Bashkiak të Sarandës; (ii) pasurinë e llojit “*truall*” për ndërtim me sipërfaqe 608 m<sup>2</sup>, përfituar nga subjekti i rivlerësimit në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.08.1999, të Këshillit Bashkiak të Sarandës; (iii) pasurinë “*apartament*” 1+1, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup> + sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup>, ndodhur në parkun e mallrave, Sarandë, përfituar nga privatizimi me Entin Kombëtar të Banesave; si dhe (iv) *aktivitetin e kultivimit të ullinjve*, në kuadër të të cilit subjekti i rivlerësimit ka përfituar në vitin 2011 subvencion shtetëror në shumën 153.000 lekë – subjekti, me veprimet e kryera për përfitim të tyre, ka cenuar etikën dhe figurën e tij si prokuror.
4. Në vlerësimin tim, veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për pasuritë e sipërcituara, ndryshe nga sa arsyeton shumica e trupit gjykues, ngrihen në nivelin e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me të njëjtin arsyetim si Komisioni, dhe meritojnë të vlerësohen në kuadër të besueshmërisë së këtij kriteri, përtej parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*